UNIVERSITETI i EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ

STUDIMET POSTDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZË MAGJISTRATURE

IMPAKTET SOCIO-POLITIKE TË GARËS ENERGJETIKE NË LINDJEN E MESME: RASTI ARABI SAUDITE-IRAN

Kandidati:

Nefail Emini

Mentori:

Prof.Dr. Ali Pajaziti

Tetovë, 2019

Deklatatë

Të gjitha fjalitë, frazat dhe idetë nga literatura e shfrytëzuar dhe të përdorura në këtë punim nga autorë të tjerë janë cituar korrekt me ndër – referenca të qarta dhe të drejtpërdrejta të lidhura me autorin, ligje, projektet, aktet normative, konventat, punime dhe web – faqe të caktuara. Pas çdo fusnotë ishte obligimi im për sqarime dhe komente plotësuese.

Si autor i punimit të magjistraturës, nëse nuk kam vepruar në përputhshmëri me normat metodologjike hulumtuese, nese jam shërbyer me kopi – past të literaturave, pa sqarime, nese punimi i diplomës mund të konsiderohet plagjiarizëm, përgjegjësia morale dhe ligjore është e imja, në këtë punim me temë:“ „-Impaktet socio-politike të garës energjetike në Lindjen e Mesme: Rasti Arabi Saudite Iran”.

Shkup, Tetovë 2019

Kandidati Nefail Emini

Nënshkrimi i kandidatit

Abstrakt

Lindja e Mesme ka qenë djepi dhe qendra e shumë civilizimeve te rëndësishme, feve dhe kulturave, e perandorive të mëdha që kanë bërë që rajoni të ketë një rëndësi që nga antikiteti deri në kohët tona. Pozita e saj gjeografike si urë lidhëse e tre kontinenteve tërhoqi interesin e fuqive të ndryshme të cilat dëshironin ta kontrollonin dhe ta dominonin rajonin. Si rezultat i rëndësisë së këtij rajoni filloi procesi i kolonializimit nga fuqitë perëndimore dhe futja e konceptit të shtet-kombit që çoi në krijimin e lëvizjeve nacionaliste dhe shteteve kombëtare. Krijimi i shteteve kombëtare solli krijimin e aleancave shtetërore mes vendeve të rajonit dhe fuqive globale.

Zbulimi i naftës në rajon ndikoi në rritjen e rëndësisë së saj në politikën botërore pasi në të gjenden rreth 65% të rezervave të naftës të zbuluara dhe rreth 45% të rezervave të gazit. Rëndësia e naftës në marrëdhëniet ndërkombëtare është evidente dhe e fuqishme, ku impaktin e saj socio-politik na e pamë në krizën e vititi 1973. Duke qenë një vend me burime të mëdha energjetike i kanë mundësuar të ardhura të mëdha ka krijuar një formë të re të shtetit e njohur si rentierizëm. Në Lindjen e Mesme kalojnë shumë tubacione të naftës dhe gazit që i mundësojnë këtij rajoni që të luaj një rol të rëndësishëm në tregun global të naftës edhe si rajon transit.

Në Lindjen e Mesme shtetet si Arabia Saudite dhe Irani paraqesin dy fuqi rajonale që kanë ndikim të fuqishëm në zhvillimet e saj. Duke qenë një rajon me burime të mëdha energjetike, të njëjtat i kanë dhënë mundësi përdorimit të diplomacis energjetike si instrumet për realizmin e interesave kombëtare të shteteve. Ekziston një garë e fuqishme energjetike dhe për ndikim mes dy shteteve me qëllim liderizmi rajonal.

Fjalët kyçe: Lindja e Mesme, kolonializmi, nacionalizmi, Fuqitë e Mëdha, nafta, gazi , rentierizmi, tubacionet, fuqi rajonale, diplomacia energjetia, dominimi

Abstract

The Middle East has been the cradle and center of many important civilizations, beliefs and cultures and of great empires that has made the region of great importance in antiquity.Its geographical position as the connecting bridge of the three continents attracted the interest of the various powers that wanted to control and dominate the region. As a result of its importance, the process of colonization by Western powers began and the introduction of the concept of nation-state led to the creation of nationalist movements and nation-states.The creation of nation-states led to the creation of state alliances between the countries of the region and global powers.

The discovery of oil in the region increased its importance in world politics as it contained about 65% of the discovered oil reserves and about 45% of the gas reserves. The importance of oil in international relations is evident and powerful where we saw its socio-political impact in the 1973 crisis. Being a country with enormous energy resources has enabled them to generate large incomes, it has created a neë form of state known as Rentierism. Many oil and gas pipelines pass through the Middle East, enabling it to play an important role in the global oil market even as a transit region.

In the Middle East, countries like Saudi Arabia and Iran represent two regional powers that have a strong influence on its developments. Being a region of great energy resources, it has enabled the use of Energy Diplomacy as a tool for realizing the national interests of states. There is a powerful energy race and a race of influence between the two states in order for each to be the leader of the region.

Key words: Middle East, Colonialism, Nationalism, Great Powers, Oil, Gas, Rentierism, Pipeline, Regional Power, Diplomacy, Energy, Domination

Апстракт

Блискиот Исток бил лулка и центар на истакнати светски цивилизации,религии и култури, на големи империи, предел од голема важност за антиктетот. Неговата географска положба е многу значајна како мост помеѓу три континенти ,кој ги привлекува интересите на големите сили, кои сакаа да го контролират и да доминират во овој регион. Како резултат на големата улога ,почна процесот на колонизацијаод Западните сили, и вметнувањето на концептот држава-нација кој придонесе за формирање на национолистички движења и национални држави. Формирањето на Националните Држави придонесе за формирањето на државните агенции помеѓу земјите на регионот и големите глобални сили.

Откривњето на нафтата во регионот придонесе за зголемување на важноста на овој регион врз светската политика ,затоа што во него се наоѓаат ололу 65% на нафтените и околу 45% на гасовните резервни. Важноста на нафтата врз билатералните меѓународни односи е евидентна и силна, со социјален и политички импакт , ни покажа кризата во далечната 1973 година. Како значаен регион со големи резерви на енергија , која овозможи големи примања и создаде една нова форма на државата позната како рентиернизам. Врз големиот Блиски Исток поминуват нафтоводи и гасоводи, кои му овозможуваат на овој регион да игра голема улога на светското пазар на нафта, но како и за транзитен рајон.

Во Средниот Исток државите како Саудиска Арабија и Иран преставуваат две регионални сили кои имат големо влијание врз неговиот развиток. Со оглед на тоа дека Регионот содржи големи енергетски извори, има можност за развивање на Енергетска Дипломатија како инструмент за реализирање на државните национали интереси. Во меѓувреме евидентна голема натпревар , конкуретнтност за влијание помеѓу овие две држави, се со една цел: преземање на лидерството во регионот.

Клучни зборови: Среден Исток, колонијализам, национализам, големи сили, нафта, гас, рентиеризам, гасовод, регионални сили, дипломатија, енергија, доминација

Përmbajtja

1. Hyrje..... 87
2. Kapitulli I: Lindja e Mesme

2.1 Histori e shkurtër e Lindjes së Mesme..... 98

2.2 Kuadri Kolonial..... 131

2.3 Nacionalizmat dhe krijimi i shteteve në Lindjen e Mesme..... 153

2.4 Gjeopolitika e Lindjes së Mesme..... 2014

2.5Fuqitë globale në Lindjen e Mesme..... 2218

2.5.1 ShBA..... 2218
2.5.2 BE..... 250
2.5.3 Kinë..... 271
2.5.4 Rusi..... 292

3. Kapitulli II: Burimet Energjetike në Lindjen e Mesme: Impaktet socio-politike

3.1 Nafta në Lindjen e Mesme..... 3124

3.1.2 Gazi Natyror 3326

3.2 Ndikimi i Naftës në mardhëniet ndërkombetare..... 3528

3.3 Impakti socio-politik i Shtetit Rentier..... 4134

3.4 Impaktet socio-politike të Naftesjëllësve dhe Gazsjëllësve..... 4437

4. Kapitulli III: Gara energjetike Arabi Saudite-Iran

4.1 Dy fuqi rajonale..... 481

4.1.1 Arabia Saudite..... 481

4.1.2 Irani..... 5245

4.2 Diplomacia Energjetike..... 5649

4.3 Impaktet socio-politike të garës Energjetike Arabi Saudite-Iran..... 6153

4.4 Përplasja Arabi Saudite- Iran për udhëheqje në rajon..... 6759

5. Intervista..... 7163

6. KonkluzionePërfundimi.....75~~67~~

7. Bibliografia..... 77~~68~~

1. Hyrje

Lindja e Mesme paraqe ndoshta rajonin i cili ka dhënë histori më shumë se çdo pjesë tjetër e botës në të cilën kanë jetuar popuj me kultura dhe besime të ndryshme. Tigri, Eufrati dhe Nili u bënë vendet e para ku filloi procesi i krijmit të civilizimieve dhe krijmit të sistemeve të ndërlikuara shoqërore nga të cilët do të fillonte periudha e ngritjes së shoqërisë njërëzore. Vend i lindjes së përandorive të mëdha si Persisë, Babilonisë, Egjiptit, Perandoris Osmane që kanë krijuar shoqëri me të cilët mahnitet sot njerëzimi. Djep i besimeve më të mëdha monoteiste të cilët vazhdojnë të formësojnë rendin botëror edhe sot. Me forcimin e shteteve perëndmore filloi edhe procesi i kolonializmit të rajonit dhe bartja e ideve të nacionalizmit dhe shtet-kombit moder. Kjo çoi drejt krimit të shteteve të pavarura në rajon të bazuar në identitet kombëtar një gjë jo e njohur për rajonin deri para shekullit XIX që çoi në krijim e shteteve moderne dhe aleancave të ndryshme. Pozita e saj gjeografike si urë lidhësë e tre kontinenteve dhe egzitimi i rrugëkalimeve ujore më të rëndësishmë të botës ishin si magnet dhe si kusht që pa sundimin e tyre sdo të mund të arrihej dominimi global. Zbulimi i naftës ishte edhe kurora që i dha Lindjes së Mesme rëndësinë e pakontestueshme strategjike për çdo shtet. Në një periudhë shumë të shpejtë nafta do të luaj një rol tejet të rëndësishime si në politikën rajonale e cila formësoi shtetet e reja po ashtu edhe në politikën globale. Të ardhurat e mëdha të realizuara nga nafta mundësoi lindjen e një forme të re të ekonomisë e njohur Rentierisëm ku shteti nuk kishte nevojë të taksonte qytetarët. Në Lindje e Mesme kalojnë shumë tubacione nafte dhe gazi të cilët i kanë dhënë edhe rolin e një rajoni strategjik tranziti të tyre. Arabia Saudite dhe Irani paraqesin dy fuqitë rajonale të cilët më një ndikim të fuqishëm në të gjitha zhvillimet që ndodhin në rajon. Egzistimi i burimeve energjetike i ka mundësuar që shtetet për interesat e veta ta shfrytëzojne diplomacin energjetike ndaj vendeve të varura prej saj. Arabia Saudite dhe Irani zhvillojnë një garë të fuqishme energjetike pasi për të dy shtetet paraqet një element shumë të rëndësishëm pushteti dhe ndikimi rajonal dhe global. Këto dy shtete janë në

një garë për sundim rajonal dhe ata mbështetin lëvizje dhe grupacione të ndryshme me qëllimin e vetëm arritjen e sundimit dhe dominimit të rajonit.

~~1.~~2. Kapitulli I: Lindja e Mesme

~~1.~~2.1 Histori e shkurtër e Lindjes së Mesme

Formatted: Outline numbered + Level: 1 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 0.5"

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Lindja e Mesme nënkupton tokat që shtrihen në nga bregu jugor dhe lindor i Detit Mesdhe, që shtrihet nga Marokoja deri në Gadishullin arabik dhe Irani, dhe sipas disa përkufizimeve edhe përtej.[1] Termi Lindje e Mesme ndonëse është një koncept politik relativisht i ri, rajon me më shumë histori se çdo pjesë tjetër e botës. Këtë term për herë të parë e përdori historiani amerikan Aflred Th. Mahan në vitin 1902 në një artikull të botuar në një revistë britanike, "National Rewiev" me titull "Gjiri Persik dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare". Sintagma Lindje e Mesme e përfshin hapësirën nga Suezi deri në Singapor. Nga të dhënat historike dhe arkeologjike konstatohet se Lindja e Mesme paraqet një rajon të banuar që nga kohërat shumë të lashta, i banuar nga popuj të ndryshëm. Konsiderohet edhe si pika e fillesës së hisotrisë apo djepi i civilizimit, po ashtu ka qënë udhëkryq për përhapjen e civilizimeve të tjera të zhvilluara në pjesët e tjera të botës. Civilizimet nuk janë fenomene natyrorer, por atë janë vepra të krijuara me vetëdije nga njeriu të cilët lindin në bashkësit shoqërore. "Sistem i besimit dhe moralit i cili në kuandër të një kornize shpirtërore i gjeneron elementët kulturor quhet civilizim"[2]. Civilizimet kanë tre element të përbashkëta si: Shtet i organizuar me kufi të caktua, Lindja e klasave shoqërore, Përdorimi i shkrimit dhe arteve të bukura. Këto elemente janë karakteristike për civilizimet që kanë lindur dhe zhvilluar në Lindjen e Mesme.

Lindja e Mesme në antikitetin e saj ka qenë nën sundimin e perandorive të mëdha si Egjipti, Mespotamia dhe Persia, që kanë mundësuar përhapjen e besimeve dhe kulturave duke krijuar një rajon me larmi besimesh, kulturash, të etnive dhe racave të ndryshme. Lindja e Mesme është jo vetëm vend i shumë perandorive por vend shumë spiritual pasi këtu kanë lindur tre besimet më të mëdha monoteiste, Hebraizmi, Krishtërimi dhe Islami që i kanë dhënë

[1] https://www.britannica.com/place/Middle-East, 03.09. 2019.
[2] Ozakpënar, Jëllmaz: Kultura dhe Qytetrimi, Logos A, Shkup 2003, fq. 58

formë jo vetëm rajonit por edhe mbarë botës. Në këto rajon gjendet edhe Jeruzalemi, qendër shumë e rëndësishmë për tri fetë monoteiste. Në rrjedhat e lumit Nil, Eufrat, Tigër u themeluan civilizimet e para të Mesopotamisë, Babilonit dhe Egjiptit që paraqesin format e para komplekse shoqërore.

"Hamurabi mbreti i Babilonisë në shekullin e 18 p.e.r formuloi kodin e parë ligjor gjithpërfshirës i cili ka mbijetuar"[3] . Ky kod u zbulua në vitin 1901, i cili është i shkruar në table guri në gjuhën akadiane sot gjendet në muzeun e Luvrit në Francë, si dhe përshkak të reputacionit si njëri nga kodet e para ligjore që është shkruar ekspozohet në shumë institucione në mbarë botën. Faraoni egjiptian Ramsesi i II, rreth shekullit XIV p.e.r. arriti të krijonte një perandori e cila do të përfshinte nën sundimin e saj thuajse gjithë rajonin e Lindje së Mesme duke krijuar të parën fuqi që arriti ta dominonte thuajse tërë rajonin. Dy perandori të cilat sunduan njëkohësisht rajonin ishin ajo perse dhe romake, të cilat patën një rivalitet të fuqishëm për hegjemoni , por që asnjëra nuk arriti që plotësisht ta ketë nën sundim Lindjen e Mesme. Perandori Romak, Agustini i cil sundoi rreth viteve 29-14 p.e.r. arriti për disa shekuj pjesën më të madhe të Lindjes së Mesme ta fusë nën juridiksionin e *Pax Romana*-s (Paqës Romake). Perandoria Perse pas disfatës që pësoi nga perandoria Romake, u detyrua të lëshonte territoret e Sirisë (Levantit) që më herët kishte sunduar, duke u tërhequr në rajonin e Mesopotamis dhe Iranin e sotëm. Lindja e Krishterizmit si fe monoteiste në Jeruzalem tronditi themelet e të dyja perandorive pasi që Zoroastrianizmi ishte botëkuptimi politeist i persianëve, kurse romakët kishin besim politeist të bazuar në hyjnitë. Romakët besonin në shumë zota, më e rëndësishmja ishte Jupiter Latiarisit që konsiderohej si mbreti i zotave në mitologjin romake, po ashtu Marsi dhe Quirinus ishin të rëndësishëm. Perandoria Romake bëri përpjekje për ta shuar këtë religjion por nuk ia doli pasi për një kohë të shkurtër Krishterizmi u përphap thuajse në të gjithë rajonin e Lindjes së Mesme. Perandori Konstantini i Madh në vitin 313 e pranoi Krishterimin si religjion dhe dhjetë vite më vonë kjo fe do të bëhet religjioni zyrtar i Perandorisë.

[3] Mansfield, Peter: *A history of the Middle East*, Penguin Books, New York, 2013, fq . 2

Në vitin 330 e.s.r. Konstandini themeloi Konstandinopojën që do të bëhej edhe qendra e perandorisë bizantine dhe ky qytet do të shndërrohej në epiqendër mondiale. Derisa marrëdhëniet mes dy perandorive karakterizoheshin nga luftrat e shpeshta dhe paqet e brishta, në horizont po shfaqej një fuqi e re e cila do ta kërcënonte supremacinë e tyre. " Nuk ishin persët ata që i dhanë fund epokës heleniste në Lindjen e Mesme por aleatët e tyre arabë"[4]. Lindja e Muhamed djalit të Abdullahut, profetit Muhamed, në vitin 571 dhe religjionit të ri monoteist, Islamit, do të nxjerrë në shesh një fuqi që do t'i japë formë rajonit dhe do të jetë shtylla e krijimit të njërit nga civilizimet më të mëdha të historisë së njerëzimit. U krijua një shtet i madh që për një periudhë shumë të shkurtër do të bëhej fuqia dominuese që do ta pushtonte thuajse të gjithë rajonin e Lindjes së Mesme, Afrikën Veriore dhe në vitin 711 ata do të shkelte edhe në Spanjën Europiane. Një përplasje brendaislame i dha formë krijimit të dy rrymave besimore, asaj Sunnite dhe Shiite, të cilat vazhdojnë të kenë një impakt shumë të madhë edhe sot në rajonin e Lindjes së Mesme duke shkaktuar përplasje sektare dhe konkurrencë mes shteteve arabe. Pas rënies së Jerusalemit nën sundimin e muslimanëve, të krishterët nën thirrjen e Papë Urbanit II në vitin 1095 i filluan kryqëzatat për rikthimin e Tokës së Shenjtë nën sundimin krishter, ndërmarrje kjo që u përmbyll në vitin 1099 kur ky qytet sërish ra në duart e të krishterëve. Nën udhëheqjen e Salahudin Ejupit muslimanët arritën që ta rimerrnin Jeruzalemin në vitin 1187. Pas kësaj date të krishterët europianë do të bënin edhe disa kryqëzata por pa mundur ta kthenin tokën e shejt deri në shekullin XX.

Në shekullin XIII Lindja e Mesme po përballej me një rrezik të tmerrshëm, atë të invazoinit mongol. Ky invazion shkaktoi tmerr dhe shkatërrime që rezultuan me kapitullimin e Halifetit Abasid në vitin 1258. Pas rënies së abasidevë, rreth shekullit XIV në Lindjen e Mesme do të krijohet një fuqi e re në rajonin e Azis së Vogël e njohur si Perandoria Osmane e cila do ta sundonte për më tepër se pesë shekuj. Në vitin 1453 sulltani Osman Mehmet Fatihu II pushtoi Konstantinopojën që ishte qendër e perandorisë bizantine dhe qendër e besimit Ortodoks, duke e emëruar si Islamboll dhe duke e shndërruar në qendër të Perandorisë. Por thuajse në të

[4] Goldschmid, Arthur Jr and Davidson Lawrence: *A Concise History of the Middle East*, Westview Press, Boulder 2010, fq. 18

njëjtën kohë në Lindjen e Mesme u paraqit një forcë tjetër, ajo e Perandoris Safevite e cila sundonte në Iranin e sotëm dhe që ishte një konkurrente për hegjemoni në rajon e Perandoris Osmane. Në përballjen mes këtyre Perandorive në betejën e Çalldëranit në vitin 1514 që përfundoi me fitoren e osmanëve. Në vitin 1516 osmanët i mposhtën edhe memlukët të cilët sundonin në Egjipt. "Si zotërues të rinj të Sirisë, Egjiptit dhe Hixhazit, osmanët tani sundonin zemrën e Islamit Arab"[5]. Kështu Perandoria Osmane do të siguronte sundimin e vet mbi Lindjen e Mesme pa një kërcënim apo pretendent tjetër rajonal për një periudhë rreth treshekullore. Perandoria Osmane falë zhvillimit dhe fuqisë kishte arritur që ta kërcënonte Europën me pushtim duke hyrë deri në zemër të saj duke e rrethar Vjenën, qendrën hasburgase në vitin 1683 por që dështoi ta pushtonte[6]. Europa e cila në atë kohë gjendej në pozitë inferioriteti ndaj fuqisë osmane, por që shumë shpejtë falë reformave dhe zhvillimit industrial do t'i tejkalonte osmanët dhe nga një Perandori e lavdishme do ta merrte epitetin "I sëmuri i Bosforit". Zhvillimi i europianëve do të rezultonte me interesa të mëdha ekonomike, politike dhe strategjike në rajonin e Lindjes së Mesme. Franca ishte shteti i parë europian i cili do të fillonte ekspeditën në Lindjn e Mesme të udhëhequr nga gjenerali i ri Naopeon Bonaparta në vitin 1798, në Egjipt. Kjo ishte hera e parë pas shumë shekujve që europianët futeshin në "Zemrën e Lindjes së Mesme". Fuqitë europiane do të përplaseshin ndërmjet veti për të siguruar qasje më të madhe në rajon dhe falë marrëveshjeve të dëmshme që u detyrun t'i nënshkruajnë osmanët ndikuan në dobësimin e Perandorisë. Lufta e Parë Botërore e vitit 1914-1918 e cila filloi si një përballje europiane pati një ndikim shumë të madh në Lindjen e Mesme që kulmoi me shkatërrimin e Perandoris Osmane dhe ndarjen e saj në mes Britanisë së Madhe dhe Francës.

[5] Goldschmid, Arthur Jr and Davidson Lawrence: *A Concise History of the Middle East*, westview Press, Boulder 2010, fq. 136

[6] Perandoria Osman e kishte rrethuar edhe më herët Vjenën gjatë kohës së sundimit të Sulltan Sulejmanit në vitin 1529, por pa rritur sukses ta pushtonte atë.

~~2.~~2.2 Kuadri Kolonial

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Dobësimi i fuqisë së Peranoris Osmane u ndoq nga fuqizimi i shteteve europiane; për këto të fundit Lindja e Mesme përbëntë një zonë interesi dhe si rezultat i kësaj dëshironin të kenë qasje apo ndikim në rajon. Britania e Madhe ishte shteti i parë europian i cili zyrtarisht vendosi një sistem të mirëfilltë kolononizimi në Egjipt në vitin 1882 e më pas në Qipro në vitin 1878. Në shekullin e XIX Persia (Irani) u nda në dy zona influence, Veriu nën ndikimin rus dhe Jugu nën ndikimin britanik. Për t'i mbrojtur rrugët tregtare për në Indi, Britania aneksoi Adenin (Jemen) në vitin 1839. Përfundimi i luftës së Parë Botërore dhe marrëveshja e Sevrit e vitit 1920 shënoi zyrtarisht përfundimin e sundimit të Perandoris Osmane në Lindjen e Mesme dhe në ketë situatë fuqia dominuese e rajonit ishte Britania e Madhe. Arabët iu kishin bashkuar britanikëve në luftë kundër osmanëve me premtimin që komisioneri britanik Henry McMahon i dha udhëheqësit të Mekës, Husejn ibn Ali, se ata do të mbështesnin pretendimet hashimite për krijimin e një shteti arab. Në maj të vitit 1916 britaniku Mark Sykes dhe ai francez François Georges-Picot edhe me përkrahjen e Rusisë arritën një marrëveshje të njohur si Sykes-Picot që parashikonte ndrarjen e Lindjes së Mesme. U përcaktuan zonat e ndarjes në të cilën Franca do të merrte Sirinë bregdetare dhe Libanin e sotëm, Britania do të merrte kontrollin mbi Irakun, Jordaninë dhe Kuvajtin që do të mundësonte kontrollin mes Detit Mesdhe dhe Gjirit Persik. Rusia do të merrte kontrollin e Ngushticave dhe Anadollin Lindor, por pas disfatës ajo hoqi dorë nga pretendimet. Kurse mbretërisë arabe ju dhurua Hixhazi, i cili në pjesën më të madhe ishte shkretëtirë, dhe që europianët nuk kishin interes për ta sunduar. Palestina u përcaktua që të ishte "një zonë ndërkombëtare". "Së fundmi, më 2 nëntor 1917, qeveria britanike iu dha mbështetje formale aspiratave të Organizatës Botërore Sioniste për të themeluar një strehë

kombëtare hebreje në Palestinë[7]. Kjo u njoh si deklarata e famshme e Balfourit në bazë të emrit të sekretarit të jashtëm britanik Lord Balfourit e që shkaktoi shumë reagime dhe kundërshti tek arabët.

Në Konferencën e Paqes në Paris u paraqitën delegacione arabe të cilat kërkonin t'i realizonin premtimet që iu kishin bërë në kohën e luftës. Mbreti hashemit Amir Faisali kërkonte që të njihet si sundues zyrtar i Sirisë e cila përfshinte (Sirinë, Libanin modern) dhe Hixhazin. Mbreti Faisal synonte të krijonte një komb të përbashkët për të gjithë arabët duke u nisur nga uniteti linguistik dhe etnik si një shpërblim për mbështetjen që ata iu dhanë Aleatëve gjatë luftës. Ai pranoi interesat britanike në Mesopotami dhe e pranoi ndëryrjen ndërkombëtare në Palestinë për gjetjen e zgjidhjes mes pretendimeve arabe dhe hebreje. Siç tregon historia, francezët dhe britanikët nuk u treguan aq bujarë ndaj pretendimeve hashemite, sidomos Franca e cila dëshironte që me çdo kusht të ruante dispozitat e marrëveshjes së Sykes-Picot.

Pozita negociuese e britanikëve ishte përforcuar pas luftës pasi kishte arritur që të pushtonte Irakun dhe Sirinë, dhe rëndësi të madhe iu kushtua Palestinës e cila në marrëveshjen e vitit 1916 do të kalonte në Administrim Ndërkombëtar dhe Mosuli i cili ishte paraparë që të kalonte në sferën franceze të infuelcës. Në takimin e San-Remos në vitin 1920 përfaqësuesit britanikë dhe francezë ranë dakord që të ndajnë mandatet në Lindjen e Mesme. Sistemi i mandateve ishte rregulluar në bazë të nenit 22 të marrëveshjes së Lidhjes së Kombeve e cila Francën dhe Britaninë i konsideronte si përgjegjëse për administrimin e mandateve dhe të cilët duhet të paraqitnin raport vjetor për progresin e tyre në krijimin e institucioneve të mirëfillta shtetërore që do të ishin parakusht për krijimin e shteteve kombëtare . "Fitimet e fundit të mëdha koloniale të Perandorisë Franceze në Lindjen e Mesme u arritën pas Luftës së Parë Botërore, kur ata fituan mandatet mbi territoret e ish-Perandorisë Osmane, mbi ato që tani njihet si Siria dhe Libani"[8]. Franca u detyrua të tërhiqej nga pretendimet e saj mbi Irakun Verior. Britanikët morën mandatin mbi Irakun dhe Transjordaninë që përfshinte Palestinën dhe

[7] Louise, Fawcett: *Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Lindjes së Mesme*, UET Press, Tiranë 2005, fq. 31

[8] *https://www.un.int/kamal/sites/www.un.int/files/The%20Ambassador%27s%20Club%20at%20the%20United%20Nations/publications/ufdu2011ahme.pdf*, fq. 7

Jordanin e sotëm. “Mandatet për Palestinën, Sirinë, Libanin dhe Irakun zyrtarisht ishin aprovuar nga Këshilli i Ligës së Kombeve në korrik 1922 dhe kishin hyrë në fuqi në shtatorin e vitit 1923”[9]. Ndërsa vetëm tre shtete ishin ato që mbetën zyrtarisht jashtë kuadrit kolonial Turqia, e cila kishte hedhur poshtë marrëveshjen e Sevrit, Irani që kishte shpallur pavarësinë më 1919 dhe Mbretëria e Hixhazit (Arabisë Saudite). Këto ndarje koloniale kanë qenë dhe vazhdojnë që të jenë burim konflikti mes shteteve në Lindjen e Mesme.

~~3.~~2.3 Nacionalizmat dhe krijimi i shteteve në Lindjen e Mesme

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane popujt e Lindjes së Mesme ishin ndarë në bashkësi fetare të njohura si “mil-lete” që përfshinin pakicat jomuslimane ndërsa bashkësia muslimane përbante “ummetin” që nënkupton se grupimi bëhej në bazë të fesë dhe jo të etnisë. Ardhja e europianëve në Lindjen e Mesme imponomi një ide e cila e cila ishte e panjohur dhe e padëgjuar për popujt e këtij rajoni, ai ishte nacionalizmi dhe krijimi i shteteve kombëtare. Kjo ide kishte lindur gjatë Revolucionit Francez e dhe kishte si synim bashkimin e të gjithë atyre që kishin një gjuhë, kulturë dhe histori të njëjtë nën një shtet të përbashkët kombëtar. Në fillesën e saj ndjenjat nacionaliste në Lindjen e Mesme u paraqitën rreth shekullit XIX si një lloj nacionalizmi fetar tek hebrejtë dhe të krishterët të cilët kërkonin që t’u bëhet ballë presioneve që ju bënin komunitetet e tjera, kurse te muslimanët ndjenjat nacionaliste përherë të parë u paraqitën tek iranianët, turqit, pastaj dhe te egjiptianët. Këto ndjenja nacionaliste ishin shprehje e reagimit kundët fuqisë dhe dominimit perëndimor. “Kur mbërriti Gjeneral Bonaparti në 1789 në Lindjen e Mesme ekzistonin vetëm dy shtete sovrane: Turqia dhe Irani”[10].

Ndjenjat nacionaliste të rajonit u forcuan shumë ndërmjet dy luftrave botërore që u provokuan me ndarjen dhe dominimin e plotë britaniko-francez të rajonit. Kufijtë e shteteve në Lindjen e Mesme janë një krijiim europian i thurur shumë keq që nuk pasqyrojnë përbërjen etnike dhe gjuhësore të popujve që janë përfshirë brenda atyre shteteve[11]. Pushtimi britanik i

[9] Mansfield, Peter: *A history of the Middle East*, Penguin Books, New York 2013, fq. 207
[10] Lewis, Bernard: *Fundi i Historisë Moderne në Lindjen e Mesme*, Botime IDK, Tiranë 2013, fq. 30

[11] Kjo thurrje e keqe ka bërë që sot në Lindjne e Mesme të ketë konteste dhe tensione të vazhdueshme të cilat kanë çuar edhe në luftra rreth kufijve shtetëror si për shembull, lufta Irak-Kuvajt, ajo Iran-Irak.

Egjiptit në vitin 1882 që ishte qendra e botës arabe ndikoi që lëvizjet nacionaliste të forcoheshin dhe të kërkonin pavarësinë nga dominimi i huaj. Veprimtaria për pavarësi u ndërpre për shkak të Luftës së Parë Botërore, por që në Konferencën e Parisit u dërgua një delegacion i udhëhequr nga S'ad Zaglul, një ish ministër i cili u refuzua dhe u arrestua, gjë që çoi në revolta dhe trazira. Pas lirimit, S'ad Zaglulit iu adresua përfaqësuesve në Konferencën e Paqes, por nga atje egjiptianët u ktyen duarbosh. Trazirat sa vinin e shtoheshin dhe kjo çoi në negociata në mes britanikëve dhe egjiptianëve që përfunduan me Traktatin e vitit 1922 nga i cili Egjipti fitoi një pavarësi të kufizuar. Me një traktat të ri në gusht të vitit 1936 Britania e njohu Egjiptin si shtet të pavarur dhe sovran dhe i mundësoi që të pranohej në Lidhjen e Kombeve një vit më vonë. Ndjenjat nacionaliste në Turqi ishin zhvilluar kryesisht nga Komiteti për Bashkim dhe Përparim dhe këto ndjenja u forcuan gjatë luftrave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore. "Traktati i Sevres-it (10 gusht 1920) e la Perandorinë Osmane vetëm me Anadollin Veri-Qëndror dhe Veriperëndimor, një rajon që më shumë përjashtonte pjesën më të madhe të popullsis turke se sa e përfshinte atë"[12]. Përmbajtja e këtij Traktati ndikoi që nacionalistët turq të mblidhen rreth Mustafa Qemalit (Ataturkut) dhe të fillonin luftën për pavarësi. Lufta për Pavarësi 1919-1923 rezultoi me krijimin e Republikës Turke dhe kjo pavarësi dhe sovraniteti i saj u njohën nga Traktati i Lozanës i vitit 1923.

Ndjenjat nacionaliste të persianëve ishin zhvlluar shumë më herët se sa të vendeve tjera të Lindjes së Mesme. Këto ndjenja u ngjallën rreth viteve 1870 si reagim ndaj kërcënimit të Rusisë. Më vonë persianët si element kërcënues e panë edhe prezencën britanike. Frika e nacionalistëve persianë ukonkretizuar në vitin 1907 nga një marrëveshje mes britanikëve dhe rusëve për të përcaktuar sferat e influencës në Persi. Në vitin 1921 nën udhëheqjen e komandantit Rezah Khan i i priu një grushtshteti që rezultoi me rrëzimin nga pushteti të dinastisë kaxhare dhe ardhjen e ti në pushtet në vitin 1925, që me pas do të linde sundimi pahlevit i cili do ta udhëheqte Persinë (Iranin) deri në vitin 1979 kur ndodhi Revolucioni Islamik.

Para Luftës së Parë Botërore është e vështirë të flitet për një nacionalizëm të mirëfillët arab. Ndarja e Lindjes së Mesme në zona të kontrolluara nga Britania e Madhe dhe Franca nxiti

[12] Carthy, Mc, Justin: *Popujt Osman dhe Fundi i Perandorisë*, Alsar, Tiranë 2017, fq. 156

lëvizjet të cilat kërkonin pavarësi të plotë dhe shkëputje nga dominimi europian. Në Arabi Abdulaziz es-Saud arriti që të bashkojë Gadishullin Arabik deri në vitin 1926 që përfshinte hapësirën nga Gjiri Persik deri në Hixhaz dhe me dalje në Detin e Kuq. Britanikët do ta njihnin Abdulazizin si sundues të Nexhdit dhe Hixhazit në vitin 1927, ndërsa në vitin 1932 ndërroi emrin duke u quajtur Arabi Saudite. Në krye të Irakut si një mandat britanik u vendos Feisali I, që në përbërje të qeverisë së tij kishte shumë nacionalistë. Prania e fuqishme britanike çoi në revoltë të madhe që ndikoi që ata ta shqyrtonin praninë e tyre në Irak. Në vitin 1930 britanikët arritën një traktat të ri që i jepte fund mandatit në Irak, më vitin 1932 u pranua pavarësia dhe sovranitetit i Irakut që u materializuan me anëtarsim në Lidhjen e Kombeve. Transjordania si një mandat britanik udhëhiqej nga Emir Abdullahu që negocioi përfundimin e mandatit në vitin 1946, por që u kundërshtua nga SHBA-të duke u penguar hyrja e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. "Vetëm në vitin 1948, kur Britania dhe Transjordania nënshkruan një traktat më pak kufizues për sovranitetin e kësaj të fundit, Transjordania fitoi njohjen amerikane, kurse vendi u pranua në Kombet e Bashkuara në vitin 1955"[13]. Palestina si një mandat britanik ishte dështimi më i madh që ka lënë pasoja prezente edhe sot e kësj dite. Shkaku i problemit të Palestinës gjendet në Deklaratën e Balfourit në të cilën Britania do të mbështeste aspiratat hebreje per një shtet kombëtar në Palestinë, gjë që u refuzua nga të gjithë arabët dhe nxiti krijimin e një lëvizje të fuqishme palestineze. Britanikët i lanë përgjegjësinë Kombeve të Bashkuara ta zgjidhnin çështjen e Palestinës. Kombet e bashkuara me rezolutën 181 në vitin 1947 vendosën që në territorin e Palestinës të krijoheshin dy shtete. Ky vendim çoi në shpërthimin e luftës mes arabëve dhe izraelitëve. Ëndrra e nacionalisteve izraelitë për një shtet u materializua në vitin 1948 me Deklaratën e Pavarsisë[14]. Kjo u refuzua nga shtete arabe të cilët filluan një luftë në vitin 1948 që rezultoi me fitoren Izraelite dhe zgjerim edhe më të madh të territoreve fillestare që i kishte fituar në bazë të rezolutës së vitit 1947. Teritori i Plalestinës u nda në mes Egjiptit i cili mori Rripin e Gazës dhe Transjordania mori Bregun Perëndimor. Në vitin 1964 në Kairo (Egjipt) formohet Organizata për Çlirimin e Palestinës, qëllimi i së cilës ishte që të çlironte Palestinën përmes luftës së armatosur si dhe ishte përfaqësuese e popullit

[13] Louise, Fawcett: *Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Lindjes së Mesme*, UET Press, Tiranë 2005, fq. 42
[14] Që nga shpallja e pavarësisë Izraeli ka zhvilluar tre luftra me koaliconet e shteteve arabe. E para ishte një ditë pas pavarësisë më 15 maj 1948, Lufta Gjashtëditore e vitit 1967, Lufta e Yom Kippurit e 1973

palestinez. Samiti i Lidhjes Arabe në vitin 1974 e caktoi Organizatën për Çlirimin e Palestinë të udhëhequr nga Yasser Arafat si përfaqësuesin e vetëm legjitim të popullit palestinez, po ashtu Organizata e Kombeve të Bashkuara e pranoi organizatën si përgjegjëse për të gjitha çështjet palestineve dhe i dha statusin e vëzhguesit si një etnitet jo-shtetëror. Në vitin 1987 shpërtheu *Intifada* (Dridhje) kundër Izraelit, që për herë të parë palestinezët që jetonin brenda morën drejtimin për udhëheqjen e revoltës kundër Izraelit. Në vitin 1993 filluan bisedimet sekrete mes Izraelit dhe Organizatës për Çlirimin e Palestinës të cilët e pranuan njëri-tjetrin si partner në negociata e njohur si procesi i paqes i Oslos. Marrëveshje e nënshkruar në vitin 1993 në Uashington e njohur si Oslo I dhe Oslo II e nënshkruar në Egjipt e njohur si Oslo II parashihte krijimin e shtetit Palesntinez. Këto dy marrëveshje nuk arritën të krijonin shtetin e Palestinës përshkak të ndasive të shumta që kishin palët. Në vitin 2000 presidenti amerikan Bill Clinton incioi një samit të njohur si Camp David për zgjidhjen e konfliktit Izraelito-Palestinez. Ky samit dështoi pasi nuk u arrit asnjë dakordësi mes palëve. Në po të njejtin viti shpërtheu *Intifada* e dytë që zgjati deri në vitin 2005 që i dha fund çdo "dakordësie" që ishte arritur më herët nga palët. Ndërsa Palestina ka marrë statusin e shtetit vëzhgues jo-anëtarë të OKB-së në vitin 2012. Ky konflikt nxiti një valë të re të lëvizjeve nacionaliste si pan-arabizmi, një ideologji kjo që kërkonte bashkimin e të gjitha shteteve arabe nga Magrebi deri në Indi.

"Naseri, një personalitet i fuqishëm dhe tëpër tërheqës, u bë një figurë e dashur, duke bërë thirrje për nacionalizmin arab"[15]. Panarabizmi poashtu ishte edhe si një kundërpërgjige ndaj shtetit të Izraelit dhe popullaritetin më të madh e arriti në vitit 1950-1970 gjatë sundimit të Naserit. Në këtë periudhë me krijimin e shteteve në Lindjen e Mesme lindën edhe lëvizje fetare islame. Një nga më të famshmit ishte Vëllazëria Muslimane e cila u themelua në Egjipt në vitin 1928 nga Hasan el-Benna, lëvizje e cila është aktive dhe influencon zhvillimet në Lindjen e Mesme. Mandati i Francës mbi Siri rezultoi me ndarjen e saj në dy pjesë: Sirinë dhe Libanin. Kjo u kundërshtua nga forcat nacionaliste siriane, por në anën tjetër kishte përkrahjen e minoritetit të krishterë Maronit. Në vitin 1926 francezët krijuan dy shtete Sirinë dhe Libanin. Këto dy shtete e fituan pavarësinë në vitin 1936. Për të realizuar pavarësi të plotë, Siria dhe Libani i bënë

[15] Kissinger, Henry: *Diplomacia*, Leart, Tiranë 1999, f.524

presion OKB-së që e detyroi Francën të tërhiqte forcat e saj në vitin 1946 dhe kështu këto vende mund të pretendonin se ishin të pavarura.

Kurdët janë një popull disa milionësh i shpërndarë në disa shtete të Lindjes së Mesme që vazhdojnë përpjekjet për krijimin e një shteti të tyre kombëtar. Katari si koloni britanike shpalli pavarësinë në vitin 1971, kurse Qiproja (poashtu koloni britanike) u pavarësua në vitin 1960. Kuvajti shpalli pavarsinë në vitin 1961 pas përfundimit të mandatit britanik. Jemeni ishte ndarë në mes sundimit osman dhe britanik që rezultoi me krijim e dy shteteve Jemenit Verior (1918) dhe Jemenit Jugor (1967), të cilët u bashkuan në vitin 1990. Bahrejni ishte protektorat britanik dhe arriti mëvetësinë në vitin 1971, kurse Emiratet e Bashkuara Arabe si protektorat Britanik e fituan pavarsinë më 1971.

4.2.4 Gjeopolitika e Lindjes së Mesme

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Faktori gjeografik paraqet një element shumë të rëndësishëm për përcaktimin e fuqisë dhe të ndikimit të një shteti apo të një rajoni në marrëdhëniet ndërkombëtare. "Pozita e Lindjes së Mesme në kryqëzimin e tre kontinenteve të Botës së Vjetër u ka dhënë prej kohësh rëndësi strategjike globale rrugëve të saj ujore dhe tokësore të kalimit"[16]. Harold Makinder me teorin e e tij gjeopolitike në vitin 1904 i dha rëndësi strategjike Lindjes se Mesme e cila gjendej në qendër të Rimlandit (Nicholas Spykamn) që e rrethonte Rusinë si një fuqi e boshtit për të mos dalur në det që do t'i mundësonte sundimin e kryekontinentit Euroaziatik[17]. "Heartland (Tokëzemër) është territori kryesor në kontekstin më të gjerë të ishullit Botëror. Mackinder përfshin tre kontinente - Azi, Afrikë dhe Evropë - në këtë ishull botëror"[18]. Kjo e shtyri Britaninë e Madhe dhe Francën që të ndërhynin në rajon për të penguar dominimin rus. "Lindja e Mesme e madhe shtrihet në 1000 milje, nga perëndimi në lindje, nga Deti Mesdhe deri në malet e Iranit. Nga veriu në jug, nëse fillojmë në Detin e Zi dhe në fund të brigjeve të detit arab nga Omani, ai është i gjatë 2000 milje"[19]. Kështu kjo zonë mundëson lidhjen e Europës me Azinë dhe me Afrikën duke e shëndrruar në urë lidhëse të tre kontinenteve më të mëdha. Kufizimi i saj me Pakistanin dhe Rusinë, dy shtete nukleare, ka bërë që gjeopolitka e rajonit të ketë një

[16] Cohen, B, Samuel: *Gjeopolitika*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2016, fq. 348
[17] Makinder vendosi tre postulate të gjeopolitikës: Ai që sundon Euro-Azinë sundon qendrën e botës, qi që sundon qendrën e botës, sundon Ishullin Botëror, Ai që sundon Ishullin Botëror sundon Botën dhe Lindja e Mesme është pjesë shumë e rëndësishme e Euro-Azisë.
[18] https://www.geopolitica.ru/en/article/halford-mackinder-geographical-pivot-history,01.09.2019.
[19] Marshall Tim: *Prisoners of Geography*, Elliott and Thompson Limited, London 2015, f. 146

rëndësi të madhe për të gjithë aktorët që dëshirojnë t'i mbykëqyrin më afër këto dy vende. Një shtet i cili ka shtuar rëndësinë gjeopolitike të Lindjes së Mesme është ishulli i Qipros. Ai gjendet në mes tre kontinenteve, Europës, Azisë dhe Afrikës, shumë afër Kanalit të Suezit, në pjesën Lindore të Detit Mesdhe. Zbulimi i naftës ja shtoi edhe më shumë rëndësinë gjeopolitike dhe strategjike rajonit. Në kuadër të Lindjes së Mesme gjendet gjysëmhëna më strategjike që përfshin Detin Kaspik dhe Gjirin Persik ku gjenden burimet më të mëdha energjetike të botës. Zonat ujore me të cilat kufizohet Lindja e Mesme ia shtojnë rëndësinë strategjike asaj. Në lindje kufizohet me Detin Mesdhe, në veri me Detin Kaspik dhe Detin e Zi në jug me Detin e Arabisë që mundëson daljen në Oqeanin Indian. Në Lindjen e Mesme ka 18 shtete me një një sipërfaqe të përgjithshme 7.207.575 kilometra katrorë.

Rrugëkalimet ujore kanë një impakt shumë të madh global pasi nga 9 kalimet më të rëndësishme ujore në botë 5 gjenden në Lindjen e Mesme. Këto kanale mundësojnë lidhjen e Oqeanit Indian me Detin Mesdhe dhe paraqesin pikat kryesore të zhvillimit të tregëtisë ndërkombëtare. Ngushtica e Bosforit mundëson lidhjen e Detit të Zi me Detin e Marmara, ndërsa ngushtica e Dardaneleve mundëson lidhjen e Detit Egje me Detin Mesdhe. Kjo iu mundëson shteteve si Rusia, Ukraina, Bulgaria, Moldavia dhe Rumania dalje në Detin Mesdhe e përmes tij në Oqeanin Atlantik ose Indian. Kanali i Suezit që u hap në vitin 1876 lidh Detin Mesdhe me Detin e Kuq dhe me Oqeanin Indian. Rëndësia e tij u tregua në vitin 1956 kur u mbyll dhe u shtetëzua nga presidenti i Egjiptit Naseri. Shtetëzimi çoi në fillimin e luftës mes Egjiptit dhe aleancës Britani-Francë-Izrael që kishin interesa të fuqishme në sigurimin e lëvizjes së lirë nëpër kanal. Ngushtica e Bab el-Mandebit lidh Oqeanin Indian me Detin e Kuq dhe me Detin Mesdhe. "Ngushtica e Hormuzit, e cila ndodhet midis Omanit dhe Iranit, lidh Gjirin Persik me Gjirin e Omanit dhe Detin Arabik"[20]. Ajo paraqet një nga pikat më të rëndësishme botërore për rrjedhën e naftës në tregjet gobale.

[20] *https://www.eia.gov/todayinenergy/detail.php?id=4430#*,08.07.2019

~~5.~~2.5 Fuqitë Globale në Lindjen e Mesme

~~1.~~2.5.1 Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Formatted: Outline numbered + Level: 3 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 1", Tab stops: Not at 1.5"

Dalja në shkenë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si një fuqi e madhe ishte relativisht e vonë dhe kjo ndodhi vetëm pas hyrjes së kësaj fuqie në Luftën e Parë Botërore në vitin 1917. Programi 14 pikësh i presidentit amerian Woodrow Wilson që përfshinte të drejtën e vetëvendosjes u paraqit si një argument i fuqishëm për arabët të cilët dëshironin që t'i shpëtonin sundimit osman dhe më vonë ambicjeve të britanikëve dhe francezëve. Kështu Amerika fitoi një simpati në vendet e Lindjes së Mesme në krahasim me qëndrimet negative që të njejtët kishin ndaj fuqive europiane. "Lufta e Ftohtë ishte çështja kryesore që i dha formë marrëdhënieve të Shteteve të Bashkuara me Lindjen e Mesme"[21]. Pas Luftës së Dytë Botërore politika e jashtme Amerikane në Lindjen e Mesme u fokusua në tri çështje: komunizmi, Izraeli dhe nafta. Me fillimin e Luftës së Ftohtë udhëheqësit amerikanë hartuan një strategji për të penguar Bashkimin Sovjetik që ishte kundërshtari i ideologjik i SHBA-së për të dominuar në rajon. Sovjetikët kishin trupat e tyre në veri të Iranit si dhe i bënin presion Turqisë për kontroll të përbashkët të Ngushticave gjë që i alarmoi amerikanët. Marrja e këtij rajoni tepër strategjik do të ndikonte në rrethimin e NATO-s, kontrolli i naftës së rajonit do t'iu mundësonte një avantazh tejet strategjik sovjetikëve dhe triumfi i komunizmit do të ndikonte në përhapjen e kësaj ideologjie në vendet e tjera. Marrja e Turqis në sferën komuniste do ti mundësonte Bashkimit Sovietik kontrollin e Mesdheut që do të ndikonte në shtimin e presionit ndaj shteteve Mesdhetare si Greqis apo Italisë që ishin aleate të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Amerika

[21] Cox,Michael., Stokes, Doug: *Politika e Jashtme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës*, Botime IDK, Tiranë 2008, fq. 261

u kundërpërgjigj me “Doktrinën Truman” duke i dhënë ndihma ekonomike dhe duke futur Turqinë në NATO në vitin 1952. Për t’iu kundërpërgjigjur agresionit sovjetik, amerikanët, në vitin 1955, me Turqinë, Iranin, Irakun, Britaninë e Madhe dhe Pakistanin krijuan Paktin e Bagdadit . Rritja e ndikimit të sovjetikëve në Egjipt dhe Siri shkaktoi që Amerika të kundërpërgjigjej me ndihma ndaj aleatëve të saj arabë dhe sidomos ndaj Izraelit. Në Luftën e Yom Kipurit në vitin 1973 Egjipti dhe Siria e sulmuan Izraelin më qëllim kthimin e territoreve të humbura në vitin 1967, sulm ky që çoi në acarim të marrëdhënieve mes sovjetikëve dhe amerikanëve. Këto dy aktorë globalë kërcënuan me një përballje bërthamore. Shkatërrimi i Bashkimit Sovjetik zhduku edhe kërcënimin e komunizmit ndaj Lindjes së Mesme. Amerika i ka dhënë mbështetje të pakufizuar shteti të Izraelit që nga krijimi i tij në vitin 1948, dhe kjo ka shkaktuar reagime të ashpra tek vendet arabe të cilat e kundërshtojnë egzistimin e shtetit izraelit. Shtetet arabe kanë refuzuar njohjen e Izraelit dhe kanë një perceptim negativ ndaj ndihmës që Amerika i jep këtij “shteti problematik”. Ky perceptim e ka vendosur Amerikën në një pozitë që ka rezultuar me humbjen e mbështetjes dhe simpatisë së botës arabe ndaj SHBA-së.

“ Shtetet e Bashkuara kanë bërë mjaft përpjekje për zbutjen e tensioneve arabo-izraelite[22]. Edhe përkundër këtyre përpjekjeve ende nuk është arritur një marrëveshje paqësore mes palestinezëve – arabëve- dhe izraelitëve. Pranimi i Jerusalemit si kryeqytet i Izraelit në vitin 2018 nga SHBA shkaktoi tensione dhe reagime të ashpra në rajon.

Elementi i dytë që e ka karakterizuar dhe që vazhdon të jetë prezent edhe sot në politikën e jashtme dhe strategjin amerikane është akcesi në burimet energjetike të rajonit

Nafta paraqet një burim shumë të rëndësishëm për funksionimin e industrive botërore. Lindja e Mesme është e pasur me sasi të mëdha të naftës, dhe rritja e varësisë amerikane nga nafta pas Luftës së Dytë Botërore, ndikoi që SHBA-të ‘ti kushtonin një rëndësi të veçantë stabilitetit të vendeve prodhuese të naftës duke krijuar aleanca dhe duke i mbrojtur këto vende nga çdo agesion i brendshëm apo i jashtëm që mund t’i rrëzikonte ato. Revolucioni Islamik i

[22] Kissinger Henry: *A ka nevoj Amerika për një politikë të jashtme*, Plejad, Tiranë 2005, fq. 249

Iranit në vitin 1979 pati një efekt tejet negativ për Amerikën, për shkak se para këtij revolucioni Irani kishte qenë një nga shtetet kryesore aleate të SHBA-së, kurse pas revolucionit u kthye në armikun kryesor të interesave amerikane në rajon.

Pushtimi irakian i Kuvajtit në vitin 1990 u pa si këmbanë alarmi për shkeljen e të drejtës ndërkombëtare; SHBA-të si fuqia kryesore botërore u mobilizua për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje, dhe me marrjen e bekimit nga Organizta e Kombeve të Bashkuara amerikanët mobilizuan një koalicion ndërkombëtar për çlirimin e Kuvajtit. Ky aksion konsiderohet si lufta e parë e SHBA-ve në Lindjen e Mesme. Sulmet e 11 shtatorit 2001 nga Al-Kaeda ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndikuan që Presidenti Bush të fillonte një fushatë globale kundër terrorizmit që çoi në pushtimin e Irakut në vitin 2003. Ky hap shkaktoi kaos dhe paqëndrueshmëri në rajon. Udhëheqja e koalicionit ndërkombëtar nga SHBA gjatë Luftës së Gjirit në vitin 1992, pushtimi i Irakut në vitin 2003 në kuadër të luftës kundër terrorit, prezenca e fuqishme në shtetet e Gjirit si Bahrej, Katar, Kuvajt, Oman, Emirate dhe Arabi Saudite, prezenca në Izrael, Turqia si anate e Natos dhe thuajse në të gjithë shtetet e rajonit tregon për një prezencë të madhe dhe paraqitet si fuqia dominuese e rajonit. SHBA-të vazhdojnë të jenë mjaft aktive në Lindjen e Mesme si ruajtëse të stabilitetit të rajonit dhe garantuesi kryesor i paqes në të.

~~2.~~2.5.2 Bashkimi Europian

Formatted: Outline numbered + Level: 3 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 1", Tab stops: Not at 1.5"

Përfshirja e shteteve europiane në Lindjen e Mesme është shumë e hershme, dhe në shekullin XX i gjithë rajoni pothuajse ishte nën ndikimi francez dhe britanik, dhe kjo e kaluar koloniale përcakton edhe rolin që kanë europianët në rajon. Evropianët pohojnë se Lindja e Mesme është pjesë e "lagjes së Evropës" dhe kjo aërsi e bën promovimin e stabilitetit politik dhe ekonomik kyç për të siguruar që problemet e rajonit nuk do të kalojnë në Evropë[23]. Procesi i dekolonializimit dhe krijimi i Komunitetit Europian do të krijonte një raport të ri të marrëdhënive mes shteteve europiane dhe ish kolonive të tyre në Lindjen e Mesme, por që gjatë zhvillimit të Luftës së Ftohtë këto raporte mbetën nën hijen e përplasjeve ideologjike. Me rënien e Bashkimit Sovjetik dhe shndërrimin e Komuniteti Europian në Bashkësi Europiane u paraqit nevoja për përcaktimin e një agjende të re. Ajo që i karakterizon marrëdhëniet mes dy palëve janë kryesisht të karakterit ekonomik dhe të sigurisë. Në vitin 1995 në Barcelonë do të nënshkruhet një marrëveshje mes vendeve të BE-së dhe vendeve të Mesdheut, një Partneritet Euro-Mesdhetar që synonte bashkëpunimin politik, ekonomik dhe të sigurisë, që si objektiv kryesorë kishte të shndërrohej në një Zonë Ekonomike-Mesdhetare që parashihej të realizohej deri në vitin 2010. Për shkak të zhvillimëve dhe arritjeve të kufizuara kjo inciativë dështoi. Në kuadër të Politikës së Re Europiane të Fqinjësisë u miratua edhe Partneriteti Strategjik në vitin 2004 mes BE-së dhe Lindjes së Mesme me qëllimin dhënien ndihmë për reforma nga BE-ja për shtetet e rajonit. Ç'e do që edhe kjo nismë dështoi. Varësia europiane nga energjia ka bërë që Lindja e Mesme të shndërrohet në një nga elementet kryesore të politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së.

---

https://fas.org/sgp/crs/mideast/RL31956.pdf, fq. 5

Varësia e BE-së nga energjia ruse është shndërruar edhe në një varësi politike që ka ngitur shqetësime dhe ky entitet (BE) kërkon mundësitë për t'u çliruar nga kjo varësi. Si shpresë për shpëtim nga kjo varësi janë gjetur vendet prodhuese të Lindjes së Mesme si dhe vendet tranzitore nga të cilat do të kalojë furnizimi. "Ndër projektet e para të këtij lloji ishte gazsjellësi Nabucco që ishte promovuar në fillim të vitit 2009 në samitin inicues në Budapestë[24]. Ky gazsjellës do të kalonte nga Turqia drejt vendeve të Europës, por zyrtarisht u ndërpre në vitin 2013. Një projekt tjetër është ai i TAP (Gazsjellësi Trans-Adriatik) që mundëson furnizimin me gaz të Europës nga Azerbajxhani dhe që do ndikon në uljen e varësisë energjetike nga gazi rus[25]. BE-ja jep kontribut drejt zgjidhjes së çështjes palestinezo-izraelite me qëllim të ruajtjes së paqes dhe sigurisë së rajonit. Kjo rëndësi për stabilitetin në rajo u pa gjatë eksodit të madh të refugjatëve në vitet e fundit i cili rrezikoi edhe ekzistimin e vetë Bashkimit Europian.

[24] Reka. B, Bashota. B, Sela Y: *Marrëdhëniet Ndërkombëtare,* Insituti për studime politike dhe Ndërkombëtare, Shkup 2018 fq. 449

[25] Rusia paraqet furnizuesin kryesor të BE-së me gaz me rreth 60% të konsumit të përgjithshëm

~~3.~~2.5.3 Kina

Formatted: Outline numbered + Level: 3 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 1", Tab stops: Not at 1.5"

Gjatë periudhës së Lufës së Ftohtë Kina si një fuqi botërore kishte mbetur nën hijen e dy superfuqive, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës sa i përket ndikimit dhe pozitës së saj në Lindjen e Mesme. Përfundimi i Luftës së Ftohtë ndikoi që Kina të zhvillonte një qasje më serioze ndaj Lindjes së Mesme pasi që shkatërrimi i Bashkimit Sovjetik krijoi një boshllëk të cilin ajo dëshironte ta plotësonte. Kina sot përbën ekonominë e dytë të planetit, me një industri të madhe dhe të fuqishme, por me burime energjetike shumë të pakta, gjë që ka bërë që ajo të jetë plotësisht e varur nga vendet eksportuese. Varësia energjetike ka ndikuar të ketë një interesim shumë të madh për vendet që zotërojnë burime të mëdha të energjisë.

Zhvillimi ekonomik i viteve 1970 bëri që Kina të ndjejë nevojën për burime të mëdha energjetike. Që nga viti 1995 Lindja e Mesme vazhdon të jetë furnizuesi kryesor me naftë i Kinës dhe kjo gjeografi paraqet një rajon strategjik për Kinën. "Në vitin 2012, Arabia Saudite ishte burimi numër një i naftës (përpara Angolës dhe Rusisë), dhe Irani ishte burimi i katërt më i rëndësishëm i naftës së importuar kineze"[26]. Arabia Saudite e furnizon Kinën me rreth 20% të totalit të saj energjetik, kurse Irani çon në Kinë rreth 10% të totalit të eksportit të naftës. Kina ka arritur një marrëveshje me Iranin që të ndërtojë një gazsjellës që do të kalojë nga Pakistani, që do të ketë një ndikim të madh në industrinë e saj dhe do ta forcojë edhe më shumë fokusin e saj në rajon. Në aspektin strategjik Lindja e Mesme ka një rëndësi shumë të madhe për shkak se Kina dëshiron që ta shtrijë ndikimin e saj përtej Azisë dhe të ketë kontroll mbi rrugëkalimet ujore që disponon rajoni, pasi rreth 60% e eksporteve kineze kalojnë nëpërmjet kanalit të Suezit, ka ndikuar që Kina të bëjë investime kolosale në Egjipt dhe Izrael. Nëpërmjet inciativës

[26] *https://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/research_reports/RR1200/RR1229/RAND_RR1229.pdf*,fq.7
Scowbell,Andrew., Nader, Alireza: *China in the Middle East*, RAND Corporation, USA 2016, fq. 7

"One Belt one Road (Një rrip, një rrugë) Kina synon ta ripërtërijë Rrugën e Mëndafshit e cila do të kalojë edhe nëpër Lindjen e Mesme dhe përmes projekteve financiare dhe infrastrukturore Kina dëshiron të arrijë dominimin e saj mbi rajonin në fjalë. Përpos interesit energjetik Kina ka edhe interesa të tjera të fuqishme ekonomike në rajon. "Depërtimi ekonomik kinez në tregjet arabe gjatë 25 viteve të kaluara ka qenë spektakolar, duke bërë që eksportet kineze në vendet arabe të shkojnë nga 10 miliardë dollarë në vitin 1990 në 220 miliardë dollarë në vitin 2016"[27]. Ekzistimi i një pakice të konsiderueshme muslimanësh brenda Kinës të njohur si ujgurët – që jetojnë në Turkistanin Lindor ose Xinjang - përbën një element shtesë që Kina të ketë marrëdhënie të mira dhe t'i ndjekë zhvillimet që ndodhin në rajon.

[27] *https://www.iemed.org/observatori/arees-danalisi/arxius-adjunts/anuari/med.2018/Chinese_Breakthrought_Arab_Bichara_Khader_Medyearbook2018.pdf* , fq. 41

~~4.~~2.5.4 Rusia

Formatted: Outline numbered + Level: 3 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 1", Tab stops: Not at 1.5"

Interesat dhe përfshirja e Rusisë në Lindjen e Mesme është e hershme dhe daton nga koha e Perandorisë Osmane në të cilën Rusia kishte arritur të merrte statusin e mbrojtëses së ortodoksëve që jetonin në kuadër të Perandorisë. Falë këti avantazhi Rusia kishte arritur të depërtonte thellë brenda shoqërisë osmane. Rusia kishte zhvilluar disa luftra me osmanët dhe persianët me qëllim marrjen e territoreve dhe rritjen e ndikimit të saj në Lindjen e Mesme. "Strategjia e Rusisë cariste për t'u shtrirë në jug në dëm të osmanëve duke përdorur elementet ortodokse u vazhdua në periudhën e BRSS-së me mjete të reja"[28]. Gjatë Luftës së Ftohtë Bashkimi Sovjetik dëshironte të kishte ndikim në rajon përmes ndihmave dhënë disa shteteve arabe, por karakteri ideologjik dhe sistemi i saj centralist solli dështimin e shteteve që ajo mbështeste si dhe pushtim i Afganistanit në vitet 1980 rrënoi besimin që bota arabo-islame kishte ndaj saj.

Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik nxorri në skenë një Rusi të dobët dhe të rrënuar dhe si e tillë ajo kishte humbur fuqinë ndikuese në rajon që rezultoi thuajse me zhdukjen e prezencës së saj. Por, me kalimin e kohës Rusia filloi përsëri të fuqizohet dhe të luajë një rol shumë të madh dhe me ndikim në Lindjen e Mesme duke u bërë përsëri protagoniste e zhvillimeve në rajon. Afërsia gjeografike me vendet e Lindjes së Mesme paraqet një element të rëndësishëm përshkak se rreth 10-15% e popullatës së Rusisë është e besimit islame, entitet ky që ka shfaqur tendenca separatiste, për ndarje dhe pavarësim nga Rusia dhe kontrolli i këtyre levizjeve paraqet çështje jetike për sovranitetin dhe stabilitetin e Rusisë. Mbështetja që Rusia i dha Sirisë gjatë Pranverës Arabe shënon përfshirjen direkte në zhvillimet e Lindjen së Mesme që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë, ndërhyrje kjo që ka për qëllim mbrojtjen e aleatit të saj të

[28] Davutogllu, Ahmet: *Thellësia Strategjike*, Logos A, Shkup 2010, fq. 422

vjetër si dhe të interesave të saj strategjike në rajon[29]. Rusia ka një aleat shumë të fuqishëm në rajon, Iranin, me të cilin ndajnë interesa të përbashkëta si balancimi i fuqisë së SHBA-ve dhe të aleatëve të tyre, interesat ekonomike të gazit dhe naftës, si dhe interesat strategjike në Detin Kaspik. Rusia i kushton një vëmendje të veçantë Turqisë për shkak se në territoret e kësaj të fundit gjenden dy nga kanalet strategjike të botës, Bosfori dhe Dardanelet, që janë me një interes të posaçëm për Rusinë sepse i mundësojnë dalje në ujërat e ngrohta të Detit Mesdhe dhe në ujërat ndërkombëtare. Rusia ka interesa të fuqishme ekonomike në vendet e rajonit të Lindjes së Mesme dhe për këtë arsye i kushton rëndësi të madhe zhvillimit dhe forcimit të këtyre lidhjeve. "Ekonomia e Rusisë është shumë e varur nga eksporti i naftës dhe gazit, gjë që e bën atë të ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimit të naftës"[30]. Rusia është e interesuar të krijoj lidhje të fuqishme energjetike me vendet e Lindjes së Mesme për shkak se rajoni ka më shumë se gjysmën e rezervave të naftës së botës; Arabia Saudite është vendi më i madh prodhues i naftës në botë, kurse Irani dhe Katari janë vendet me rezervat më të mëdha të gazit natyror në botë. Rusia synon që me anë të marrëveshjeve me Arabinë Saudite të rrisë çmimin e naftës në mbi 60 dollarë për fuçi pasi që paraqet një çmim të favorshëm për të, me impakt direkt në të ardhurat kombëtare të saj. Energjia paraqet një instrumet të fuqishëm presioni të politikës ruse.

[29] Baza e vetme detare ushtarake e Rusis në Detin Mesdhe është në qytetin Sirian të Tartusit
[30] *https://www.ui.se/globalassets/ui.se-eng/publications/ui-publications/2019/ui-paper-no.-2-2019.pdf*, fq. 35

~~2.~~3. Kapitulli II: Burimet Energjetike në Lindjen e Mesme: Impaktet socio-politike

~~2.1~~3.1 Nafta në Lindjen e Mesme

Lindja e Mesme falë pozitës gjeografike dhe kulturës së saj qysh në të kaluarën ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë njerëzore dhe si e tillë ka qenë një magnet për fuqitë që të kenë një ndikim në të. Ajo që i ka dhënë formë dhe pozitë të fuqishme strategjike Lindjes së Mesme në politikën dhe ekonominë ndërkombëtare janë burimet e stërmëdha energjetike të rajonit e që përbejnë rreth 65.5% të të gjitha rezervave botërore të zbuluara. Kjo lëndë do të shëndrrohet në "gjakun" e industrisë botërore pa të cilin ajo s'do të mund të funksionontе. Historia e zbulimit të naftës në Lindjen e Mesme është relativisht e re: kërkimet për të fillojnë në dekadë e parë të shekullin XX. " Në vitin 1901 një aventurier i pasur i vendosur në Londër, Wiliam Knox d'Aris, merr nga Shahu i Persisë një koncesion për një sipërfaqe rreth 700.000 kilometra katrorë, një sipërfaqe kjo më e madhe se ajo e Teksasit"[31]. Kështu në vitin 1908 u themelua kompania e parë e naftës në Lindjes e Mesme që ishte Anglo-Persian Company e cila filloi që në vitin 1911 të nxirrte naftë nga toka persiane. Kjo ngjalli interesin e qeverisë britanike dhe njeriu i parë që e kuptoi rëndësinë e naftës ishte Winston Churchill-i i cili qysh në vitin 1911 ishte hsprehur si në vijim: "Ose duhet të bëhemi zotëruesit e kompanisë anglo-iraniane ose duhet të kemi kontroll mbi sasin që ne kemi nevojë." Në vitin 1914 qeveria britanike bleu rreth 51% të kompanisë së zënë ngoje duke u bërë kështu shteti i parë zotërues i naftës së Lindjes së Mesme. Para Luftës së Parë Botërore bota konsumote rreth 6 milionë fuçi në vit, kurse në vitin 2018 janë konsumuar rreth 99 milion fuçi. Këto shifra flasin për rëndësinë dhe impaktin që ka ky burim në ekonominë dhe politikën ndërkombëtare. Çmimi i një fuçie nafte në vitin 1900 sillej në rreth 1.20 dollar, në vitet 1930 në rreth 1.19 dollarë, kurse në vitin 1960 me themelimin e OPEC-ut (Organizata e Vendeve Prodhuese të Naftës) çmimi arriti në rreth 1.80 dollar. Gjatë

[31] Laurent, Eric: *Ana e Fshehtë e Naftës*, Botime 55, Tiranë 2014, fq. 24

krizës së naftës së vitit 1973 çmimi u ngrit në 12 dollarë, kurse çmimin më të lartë e ka arritur në vitin 2008 rreth 145 dollarë për fuçi, që paraqet edhe çmimin më të lartë të arritur ndonjëherë. Ky burim energjie shumë shpejt do ta zëvendësonte qymyrin si burim parësor energjie, duke e vendosur naftën në të gjitha llogaritë strategjike që bëhen lidhur me të adhmen e rajonit. Irani deri në vitin 1950 ishte eksportuesi më i madh i naftës në botë, deri atëherë kur disa shtete të tjera do të fillojnë të dominojnë prodhimin e naftës. Irani vazhdon jetë një shtet i rëndësishëm për shkak të rezervave të mëdha të naftës që disponon: ka rreth 160 miliardë fuçi naftë rezervë, duke dalë si një nga katër vendet me rezervat më të mëdha të energjisë në botë.

Në vitin 1933 sauditët i dhanë kompanisë amerikane "Standard Oil" një koncesion që iu mundësoi SHBA-ve të futen në vendet e Gjirit, pa qenë në dijeni se kishin zbuluar rezervën më të madhe të naftës në botë. Në Arabinë Saudite nafta filloi të prodhohet në vitin 1938, me një prodhimtari të ulët, që pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore do të shënojë rritje të madhe. Arabia Saudite ka rreth 266 miliardë fuçi rezervë naftë, duke u radhitur si vendi i dytë në botë për nga rezervat naftare. Iraku, merreth 142 miliardë fuçi naftë rezervë, filloi ta prodhonte naftën në vitin 1928; ai llogaritet si vendi i pestë në botë për nga rezervat. Prodhimi i naftës në Kuvajt filloi në vitin 1946, duke shënuar rritje të shpejtë: në vitin 1953 e ka kaluar edhe sasinë e prodhuar nga sauditët. Rezervat e Kuvajtit llogariten në rreth 101 miliardë fuçi, duke zënë vendin e gjashtë në botë. Emiratet e Bashkuara Arabe kanë rreth 97.80 miliardë fuçi naftë rezervë[32]. Katari ka rreth 25 miliardë fuçi rezervë. Edhe shtetet e tjera të Lindes së Mesme kanë rezerva të naftës por pa një ndikim aq të madh në tregun botëror. Në vitin 2011 vendet e Gjirit prodhuan 22 milionë fuçi në ditë, duke u shëndrruar në rajonin kryesor për furnizim me naftë në botë. Në bazë të parashikimeve, kërkesa për naftë do të rritet me rreth 9.1% deri në vitin 2025 dhe me pakësimin e rezevrave të vendeve të tjera,nafta e Lindjes së Mesme do të jetë burimi kryesor i furnizimit dhe zhvillimit të industrisë botërore.

[32] *https://www.opec.org/opec_web/en/data_graphs/330.htm*, 12.07.2019

Formatted: No underline, Font color: Auto

Formatted: No underline, Font color: Auto, German (Germany)

Formatted: Font: 11 pt, German (Germany)

~~5.~~3.1.1 Gazi Natyror

Formatted: Outline numbered + Level: 3 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 1", Tab stops: Not at 1.5"

Përdorimi i shumtë i naftës dhe varësia e shumë vendeve nga ky burim çoi që të mendohej për një alternativë të mundshme energjetike. Rëndësia e një burimi të ri energjie si gazi natyror, që kishte qenë i pranishëm që në momentet e para që u zbuluan fushat e naftës, jo vetëm që nuk u kuptua, por u shfaq si një problem pasi nuk dinin ç'të bënin më këtë produkt "të papërdorshëm". Atëbotë e digjnin në fushat e naftës. Sipas vlerësimeve të bëra nga British Petroleum për 2012, Lindja e Mesme zotëron 40.1% të totalit të rezervave të provuara." Irani është në vendin e parë me 33 600 bcm (miliardë metra kub), ndjekur nga Katari me 25 100 bcm, Arabia Saudite me 8200 bcm, Emiratet e Bashkuara Arabe me 6100 bcm, Iraku me 3 600 bcm, Kuvajti me 1 800 bcm" [33]. Në vitin 2017 prodhimi i gazit natyror në Lindjen e Mesme ishte rreth 609 miliardë metër kub ose rreth 28% të prodhimit të përgjithshëm botëror dhe me tendencë të fuqishme rritjeje. Irani përmban rezervat më të mëdha të gazit në rajon me rreth 17% të totalit të gazit të zbuluar në botë; rajoni i Persisë Jugore përmban rreth 40% të gjithë totalit të gazit Iranian, por për shkak të sanksioneve ky vend nuk ka arritur që të shndërrohet në eksportuesin kryesor të gazit. Vend kryesore në të cilin Irani eksporton gaz është Turqia, të cilin vitin e kaluar e furnizoi me rreth 8 miliardë metër kub gaz natyror, duke u shëndrruar në furnizuesin kryesor të Turqisë dhe me tendencë rritjeje. Gazi natyror është faktori që ka ndikuar që energjia të shëndrrohet në elementin bashkues të qëndrimeve të dy vendeve rreth zhvillimit

[33] *http://www.globeco.ro/wp-content/uploads/vol/split/vol_2_no_1/geo_2014_vol2_no1_art_002.pdf*, fq. 12

Formatted: Not Superscript/ Subscript

Formatted: No underline, Font color: Auto

të rajonit. Irani eksporton në Armeni, synon që në vitin 2019 të fillojë furnizimin me gaz edhe të Omanit.

Irani synon që të fillojë eksportin edhe në Pakista me anë të një tubacioni rreth 2000 km, që po ashtu do të mundësonte që përmes Pakistanit të furnizonte me gaz Kinën dhe Indinë. Kjo e ka shëndrruar Iranin në një pikë tejet të rëndësishmë ekonomike dhe politike dhe ka ndikuar në forcimin e pozitave të Iranit në politikën ndërkombëtare. Katari është vendi i tretë në botë për nga rezervat e gazit natyror. Irani eksportoi pak më shumë se 106 miliardë metër kub në vitin 2015 dhe mbetet eksportuesi më i madh i gazit në botë"[34]. Katari kryesisht eksporton në vendet aziatike si Japonia, Korea e Jugut, India, por edhe në Europë. Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe janë eksportues të gazit natyror por prodhimi mbetet relativisht i ulët dhe pa një ndikim të rëndësishëm në tregun global të gazit pasi që sasia e prodhimit më së shumti përdoret për konsum të brendshëm.

Në Lindjen e Mesme është zbuluar edhe një sasi tjetër shumë e madhe e gazit natyror në vitet 2009 dhe 2010. "35 trilion metra kub gaz natyror ishte zbuluar në ujërat e Izraelit dhe Qipros, me mundësi për të gjetur 85 trilion metra kub të gazit natyror në brigjet e Izraelit, Sirisë, Libanit dhe Palestinës[35]. Kjo sasi e gazit natyror e zbuluar në këtë pjesë të planetit do të nxisë dhe do t'i acarojë më tej raportet e brishta mes këtyre vendeve ku çdonjëri do të pretendojë se ky burim i ri energjie do t'i japë vendit gjegjës pozitë dhe fuqi të re politike, stategjike dhe ekonomike. Tendencat janë shpresëdhënëse për rritjen e përdorimit të gazit nga vendet konsumuese për shkak të nivelit të ulët të ndotjes që shkakton dhe çmimit më ekonomik.

Formatted: Indent: First line: 0.5"

Formatted: Indent: First line: 0.5"

[34] *http://www.apicorp.org/Research/EnergyReseach/2016/APICORPEnergyResearch_V02_N01_2016.pdf*, fq. 1

[35] https://www.econstor.eu/bitstream/10419/193035/1/ees_17_4_fulltext_02.pdf, fq. 653

Formatted: Indent: First line: 0.5"

Formatted: Left

Formatted: Indent: First line: 0.5"

~~6.~~3.2 Ndikimi i naftës në marrëdhëniet ndërkombëtare

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Që në momentin e parë të zbulumit dhe të prodhimit në Lindjen e Mesme nafta u shndërrua në një element të fuqishëm interesi për shtetet të cilat ishin të varura nga ky burim energjetik. “Duke qenë se ajo është më se e domosdoshme në të gjitha fushat e zhvillimit

ekonomik, ushtarako-strategjik dhe politik të të gjitha vendeve, është e qartë se furnizimi me naftë po fiton rëndësi gjithnjë e më të madhe ndërkombëtare"[36]. Britania e Madhe ishte fuqia e parë që e mori seriozisht burimin e ri të energjisë që u zbulua në rajon, kështu që nafta u shëndrrua në një element shumë të rëndësishëm të politikave britakike të ndjekura në rajonin e Gjirit Persik, kurse fuqitë e tjera nuk kishin një qëllim të tillë. Pasuria e vendeve të Gjirit me naftë iu ka dhënë atyre një rol shumë të rëndësishëm në marrëdhëniet brendarajonale dhe në ato ndërkombëtare në krahasim më territoret dhe popullsitë e tyre. Nafta e prodhuar në Persi si dhe kalimi i saj nëpërmjet kanalit të Suezit nga ana e britanikëve i mundësoi Britanisë dhe aleatëve të saj të Antantës fitimin e Luftës së Parë Botërore. Nafta do të kishte një rol shumë të fuqishëm në krijimin e shteteve të reja në Lindjen e Mesme pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane. "Britania donte ta ruante ndikimin e saj mbi atë që ishte e njohur si Mesopotami, mbi krahinën e perandorisë turke tashmë të vdekur, që më vonë do të njihej si Irak".[37] Besohej së në këtë zonë mund të kishte sasi të mëdha të naftës që britanikët synonin t'i përvetsonin. Kjo më së miri verëhet në krijimin e Irakut. Në marrëveshjen e San Remos britanikët morën mandatin për një shtet që u krijua nga bashkimi i tre provincave osmane, nga ajo e Bagdadit, Basrës dhe e Mosulit. Nafta ka pasur një ndikim shumë të fuqishëm në përcaktimin e kufijve dhe në furnizimin e shteteve të pasura me këtë burim energjetik. Sikur të mos ishte nafta harta e Lindjes së Mesme do të ishte shumë më e ndryshme, madje mund të thuhet se disa shtete, si Bahrejni apo Kuvajti, nuk do të mbijetonin. Sot disa shtete të vogla që ekzisojnë në Gjirin Persik janë si rezultat i drejtëpërdrejtë i burimeve të mëdha të naftës që disponon nëntoka e këtyre vendeve që iu kanë mundësuar funksionimon dhe ekzistimine si etnitete të pavarura shteterore.

Franca dhe Britania e Madhe kishin arritur marrëveshje për ndarjen e rajonit pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, por kjo shkaktoi tensionim të marrëdhënieve dhe u denoncua nga amerikanët si kolonializëm. SHBA-ja paralajmëroi sanksione kundër ish-aleatëve

[36] Vukadinoviq, Radovan, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*,Victory, Prishtinë 2005, fq. 86

[37] Yergin, Daniel., The Prize: *The Epic Quest for Oil, Money*, and Power, Simon&Schuster, USA 1991, fq. 184

pasi sipas saj marrëveshja ishte shumë e padrejtë. Në fakt Amerika kërkonte hise në naftën e Lindjes së Mesme në një kontekst kur britanikët ishin zotëruesit kryesorë të saj përmes kompanisë Anglo-Persiane, kurse francezët përmes "Compagnie Française des Petroles". Zbulimi i naftës në Irak ndikoi me krijimin e sistemit që do të kontrollonte naftën e vendeve të Gjirit Persik. Gurthemeli ishte praktika e Kompanisë Irakiane të Naftës. Në bazë të emrit dukej si Kompani nacionale Irakiane, por në realitet ajo zotërohej nga kompanit e huaja të naftës. Në këtë kompani britanikët do të kontrollonin rreth 50% të naftës me kompanitë Anglo-Persiane dhe Royal Dutch "Shell", kurse amerikanët do të kontrollonin rreth 25% të naftës përmes "Standard Oil New Jersey" dhe "Standard Oil", kurse Francezët rreth 25% përmes kompanisë së njohur "Total". Marrëveshja e Grupit" e vitit 1928 (e njohur si Marrëveshja "Linja e Kuqe") u realizua midis disa ndërmarrjeve amerikane, britanike dhe franceze në lidhje me burimet e naftës brenda territoreve të dikurshme të Perandorisë Osmane në Lindjen e Mesme [38].

Në bazë të kësaj marrëveshjeje asnjë shtet nuk mund të merrte koncesione në ish-vendet e Perandorisë Osmane, por vetëm në bazë të kombinimeve që ishin bërë në Kompaninë Irakiane të Naftës. Kuvajti nuk hyri në këtë llogaritje dhe si e tillë kompania Anglo-Persiane morri rreth 50%, kurse kompania amerikane "Gulf Oil" do të merrte 50%. Arabia Saudite nuk ngjalli asnjë lloj interesi nga ansjëri shtet për koncesione, por po në këtë vend kompania amerikane "Standard Oil" do të bënte zbulimin e rezervuarit më të madh të naftës në botë.

Lufta e Dytë Botërore do të shënonte tronditje në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe nafta do të shndërrohej në elementin përcaktues të fitores apo humbjes së luftës si dhe do të fillonin kalkulimet e rindarjes se rajoneve mbajtëse të naftës. "Në vitin 1943, duke treguar me gisht në hartën e rajonit të Lindjes së Mesme, presidenti Ruzvellt i tha fare pa dorashka ambasadorit britanik Lord Halifaks se "Nafta persiane është e juaja. Ne do ta ndajmë së bashku naftën e Irakut dhe Kuvajtit. Sa për naftën e Arabisë Saudite, ajo është e jona"[39]. Kjo paraqet përfshirjen politike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Lindjen e Mesme si dhe paraqet periudhën e kalimin të fuqisë dominuese të rajonit, Britania e Madhe, tek fuqia tjetër botërore

[38] https://history.state.gov/milestones/1921-1936/red-line, 18.07.2019
[39] Brzezinski, Zbingniew: *Vizioni Strategjik*, Instituti i Studimeve Ndëkombëtare, Tiranë 2012, fq. 16

që po lindte, SHBA. Irani mbante vendin e parë të prodhimit të naftës deri në vitin 1950, Mohamed Mosadekut kur erdhi në pushtet e shtetëzoi kompaninë e naftës dhe hodhi poshtë kontratat që kishte bërë Irani me Britaninë. Kjo shkaktoi reagime të fuqishme dhe tronditje politike e ekonomike në botë pasiqë Iranit iu vunë sanksione të fuqishme ekonomike dhe bojkotohej nafta e saj. Kjo kulmoi me rrëzimin e tij nga pushteti në vitin 1953 dhe rikthimin përsëri të Shahut që mundësoi që kompania Anglo-Persiane të vazhdonte të prodhonte dhe të shiste naftën iraniane por me disa ndryshime: kompania britanike nuk do të kishte më kontroll të plotë mbi naftën që prodhonte ky vend. "Nafta në atë kohë shitej për rreth dy dollarë fuçia dhe shtatë kompanitë e mëdha ndërkombëtare, ndonjëherë të quajtura "shtatë motrat" përcaktonin sasinë që duhej prodhuar[40].

Ngjarja e Iranit u pa si një mundësi dhe alternativë për vendet tjera naftëprodhuese që të realizonin më shumë të ardhura dhe të kenë një politikë më të pavarur në prodhimin dhe shitjen e naftës së tyre që shumë shpejt do të bëhej realitet. "Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës Arabe (OAPEC) është një organizatë rajonale ndërqeveritare e themeluar me një marrëveshje të nënshkruar në Bejrut më 9 janar 1968 nga Kuvajti, Libia (në atë kohë Mbretëria e Libisë) dhe Mbretëria e Arabisë Saudite"[41]. Më pas kësaj organizate iu bashkuan edhe shumë vende të tjera naftëprodhuese të Lindjes së Mesme. Kësaj organizate i parapriu krijmi i një organizate tjetër e njohur si Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC) në vitin 1960 ku katër nga pesë shtetet themeluese ishin nga Lindja e Mesme (Iraku, Irani, Kuvajti dhe Arabia Suadite). Këto organizata kishin si synim të krijonin një politikë të përbashkët të sasisë së prodhimt dhe të çmimeve. Në këtë mënyrë ata synonin të ishin lojtarët kryesorë të industrisë së naftës si dhe në raste të caktuara, të mund ta shfrytëzonin naftën si element diplomatik apo presioni, e sidomos në kohën kur në rajon po ndodhnin zhvillime dhe lëvizje të mëdha në vitet 1960, kur u krijuan këto organizata. Lufta e 6 tetorit e vitit 1973 mes Egjiptit dhe Sirisë kundër Izraelit, e njohur si Lufta e Yom Kipurit, që do të shëndrrohej edhe në përballje jo vetëm në fushën e betetejës por edhe në përballje të fuqishme politke dhe ekonomike që ka

[40] Nye, Joseph S., Jr: *Understanding International Conflists*, Longman, New York 2003, fq. 206

[41] *http://oapecorg.org/Home/About-Us/History*, 19.07.2019

Formatted: Font: Not Italic

lënë gjurmë të pashlyeshme në vendet që janë të varura nga burimet energjetike të vendeve eksportuese, si dhe ngjarjet e 1973 do të merren parasysh në hartimin e politikave energjetike. Vendet Arabe prodhuese të naftës i kërkuan Izraelit që të lëshonte menjëherë territoret e pushtuara në luftrat e fundit dhe t'i jepte fund shtypjes ndaj palestinezëve. Për të arritur qëllimet shteteve arabe do të përdornin varësinë nga nafta e tyre, do ta shfrytëzonin si një mjet presioni për ta detyruar Izraelin t'i realizonte kërkesat e tyre. Ishte hera e parë kur nafta synohej të përdorej si një armë politike dhe ekonomike. Ndërkohë, vendet prodhuese të Gjirit të njohura si "Gjiri Gjashtë" ku bënin pjesë Irani, Iraku, Arabia Saudite, Kuvajti ,Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe njoftuan vendosjen e shkurtimit të prodhimit të naftës dhe rritjen e çmimit në vitin 1973.

Vendet e para që u përballën me këtë embargo ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës si mbështetëse të Izraelit, si dhe Holanda, listë kjo që do të zgjerohej edhe më tej. Vendet prodhuese të naftës lajmëruan se prodhimi i naftës do të ulej me rreth 25% në krahasim me prodhimet e muajit shtator të po atij viti, pra një shkurtim shumë i madh për një periudhë shumë të shkurtër që do të kishte impakte të fuqishme politike dhe sociale. "Rritja tjetër e rëndësishme e çmimeve në këtë krizë nafte ndodhi pas një takimi të "Gjirit Gjashtë" të OPEC-ut në dhjetor 1973, ku u vendos që çmimi të rritej nga 5.12 dollarë në 11.65 dollarë për fuçi"[42]. Ngritja e çmimeve të naftës ishte tronditëse, për rreth 7 muaj çmimet u ngritën deri në 13.06 dollarë, rritje kjo për 500%. Në mars të vitit 1974 u hoq embargoja ndaj Shteteve të Bashkuara kurse në muajt në vazhdim edhe ndaj vendeve të tjera. Edhe pse embargoja nuk zgjati shumë, efektet e saj politike, ekonomike dhe soociale ishin të fuqishme. Në aspektin ekonomik ishte një goditje e fuqishme, pasiqë para krizës energjetike, ekonomia globale shënonte rritje, kurse pas krizës, ekonomia botërore shënoni shifra tepër negative. Në këtë krizë shtetet prodhuese të naftës treguan se nafta mund të përdorej si një mjet politik për t'i realizuar qëllimet dhe se sa i rëndësishëm është qëndrueshmëria dhe stabiliteti i këtyre shteteve për sistemin politik ndërkombëtar. Kjo krizë tregoi brishtësinë e vendeve të varura nga nafta dhe faktin se sa të ndikueshme janë ato nga çdo ngjarje që ndodh në Lindjen e Mesme. Kjo krizë i shtyri shtetet të ndërtojnë një politikë të mirëfilltë energjetike dhe të krijojnë raporte të mira me vendet që

[42] *https://www.files.ethz.ch/isn/20499/rev%20Oil_Price_ShocksI.pdf*

prodhojnë naftë. Kriza e dytë energjetike u provokua përsëri nga zhvillimet që ndodhën në rajon pas 1978-ës. Revolucioni Islamik i Iranit, Kriza e Pengjeve në ambasadën amerikane në Teheran dhe lufta Irako-Iraniane e vitit 1980-1988 iu dha jetë këtyre krizave. Pas ardhjes së Humejnit në pushtet, nafta shkoi nga rreth 15 dollarë për fuçi në rreth 30 dollarë, që ishte një rritje 100%, kurse prodhimi ra me rreth 5%. Kriza e pengjeve bëri që komuniteti ndërkombëtar t'i vendosë Iranit sanksione, për pasojë, njëri nga vendet me rezervat më të mëdha të naftës nuk mund të eksportonte naftë, gjë që shkaktoi mungesë e saj në tregun botëror.

Lufta Iran-Irak që u bë për supremaci mes dy shteteve, pati një impakt shumë të fuqishëm ekonomik dhe politik. Prodhimi u tkurr me rreth 12% dhe një fuçi shkoi nga 30 dollarë në 99 dollarë në vitin 1981, që ishte e barabartë me rritje rreth 160% që nga koha e para Revolucionit 1979. Edhe kriza e dytë energjetike pati efektetet e veta, por jo në atë masë që kishte kriza e parë e vitit 1973. Kriza e tretë energjetike u shënua në vitin 1990 kur Iraku e pushtoi Kuvajtin. Iraku shprehte arsye politike dhe ekonomike për të bërë një veprim të tillë: Kuvajtin gjithnjë e kishte konsideruar si pjesë e Irakut, rezervat e naftës së dy vendeve gjendeshin në vijat e tyre kufitare. Iraku dëshironte t'i rriste çmimet e naftës për t'i kompensuar shpenzimet e luftës 8 vjeçare më Iranin. "Tani jo vetëm mund ta grabiste thesarin e Kuvajtit, por duke i marrë fushat e tij gjigante të naftës mund të kontrollonte 20% të furnizimeve të naftës në botë dhe, në këtë mënyrë i zinte për fyti edhe vendet perëndimore që i urrente"[43].

Ky pushtim shkaktoi panik dhe frikë në tregjet ndërkombëtare për shkak të mundësisë për një krizë të re energjetike, e treta në dy dekadat e fundit. Kjo luftë shkaktoi reduktimin me rreth 25% të prodhimit në vendet arabe, çmimi shkoi nga 16 dollarë për fuçi, në rreth 32 dollarë për fuçi. Shtetet e Bashkuara të Amerikës si fuqia dominuese që kishte dalë nga Lufta e Ftohtë nuk do ta toleronte një kriz të re, kështu që me anë të një rezolute të Kombeve të Bashkuara udhëhoqi një koalicon për çlirimin e Kuvajtit dhe lufta përfundoi në vitin 1991 me mposhtjen e Irakut, i cili u detyrua që të tërhiqet nga territori i Kuvajtit. Çmimet e naftës u rikthyen në

[43] Stoessinger G. John: *Përse kombet shkojnë në Luftë*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2015, fq. 341

gjendjen e mëparshme në rreth 18 dollarë. Kjo krizë nuk kishte efekte të mëdha në ekonominë botërore. Në aspektin politik kjo luftë kishte një impakt shumë të fuqishëm. Iraku u mposht nga forcat e koalicionit dhe iu vendosën sanksione. Ky dobësim i Irakut solli qetësi në vendet tjera naftëprodhuese të Gjirit pasi Iraku ishte shndërruar në një kërcënim për stabilitetin dhe sigurinë e të gjithë rajonit. Përpos ndikimit në marrëdhëniet ndërkombëtare, nafta ka pasur ndikim të fuqishëm edhe në marrëdhëniet brenda rajonit apo në marrëdhëniet ndërarabe[44].

Në atë periudhë marrëdhëniet mes shteteve të pasura me naftë që llogariten si shtete të reja dhe shteteve që janë të varfra për nga ky burim por që kanë të kaluar historike. Ideologjia e panarabizmit, e udhëhequr nga presidenti egjiptian Naseri dhe partia Ba'ath në Siri, në fillim nuk ishte e lidhur drejtëpërdrejt me naftën, por më vonë ajo synonte që të ketë qasje në të ardhurat që realizoheshin nga ky burim, pasi prijësit e saj pretendonin të drejta mbi të nëpërmjet subvencioneve apo ndihmave buxhetore për vendet që ishin të varfëra nga ky burim. Kjo u kundërshtua nga shtetet naftëprodhuese që rezultoi me acarim të raporteve mes shteteve arabe të rajonit. Kështu, shtetet e "vjetra" nuk mund të pranonin se kishte ndryshuar balanca e fuqive në rajonin në të cilin nafta e vendeve të "reja" do të ishte më e fuqishme se ushtritë dhe paraja do të ishte më e fuqishme se sa populli.

~~7.~~3.3 Impaktet~~Efektet~~ socio-politike të shtetit rentier

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Teoria e rentierizmit synon t'i shpjegojë marrëdhëniet mes shtetit dhe popullit. Shtetet rentiere dallojnë nga shtetet e tjera në atë se derisa shtetet e tjera "normale" marrin taksa nga populli për të mundësuar funksionimin e tyre, shtetet rentiere nuk marrin taksa nga populli ose

[44] Shtete si Egjipti dhe Siria që ishin të varfra me burime energjetike kërkonin që këtë mungesë ta kompensonin përmes të ardhurave që do të merrnin mga shtetet e pasura të Gjirit.

e taksojnë atë shumë ulët, por ato sigurojnë të ardhura nga shitja e naftës me të cilën e mbushin arkën shtetërore, dhe nga ato të ardhura një pjesë iu shpërndahet popullit. “Rentat janë përcaktuar si "të ardhura që rrjedhin si dhurata nga natyra" dhe kështu zakonisht kuptohet se janë të ardhura të grumbulluara nga eksporti i burimeve natyrore, veçanërisht nafta dhe gazi”[45]. Funksioni kryesor i shtetit në një sistem rentier është shpërndarja e të ardhurave të realizuara nga jashtë drejt qytetarëve të saj. Shpërndarja e të ardhurave nga renta bëhet në formën e subvencioneve, ndihmave sociale, investimeve publike. Të gjithë shtetet e Gjirit konsiderohen si shtete me ekonomi rentiere. Rrënjët e rentierizmit i hasim në fillim të viteve ‘50 kur vendet e Gjirit Persik u bënë prodhues të mëdhenj të naftës dhe filluan t’i shtetëzonin kompanitë prodhuese. Rentierizmi u forcua sidomos pas embargos dhe rritjes së çmimit në vitit 1973, kur vendet prodhuese të naftës realizuan fitime të mëdha, dhe kjo gjeneroi ndryshime të shumta socio-politike në rajon. Shtete rentiere mund të quhen ato të cilat më shumë se 40% të të ardhurave të tyre ekonomike i bazojnë te nafta dhe çmimi i saj është shumë i rëndësishëm për këto shtete, pasi sa më i lartë të jetë çmimi aq më shumë të ardhura do të realizojnë. Në bazë të sloganit se “Nuk ka përfaqësim pa taksim” rentierizmi ka pasur një ndikim shumë të fuqishëm në jetën politike të këtyre vende duke çuar në një ngurtësim politik dhe në konsolidim të sistemeve monarkiste ku lindi edhe sllogani “Pa taksim, pa përfaqësim”.

Valët e demokracisë kanë filluar rreth 200 vjet më parë, por shtetet e Gjirit Persik ende nuk i ka kapluar ky sistem i përfaqësimit popullor. “Realitetit nuk mund t’i fshihesh. Nga njëzet e dy antarët e Lidhjes Arabe, asnjëri prej tyre nuk është demokraci elektorale, kur 63% e vendeve të botës janë të tilla”[46]. Në bazë të raportit të Freedom House të vitit 2010 të gjitha vendet e Gjirit janë jo të lira me përjashtim të Kuvajtit që është klasifikuar si pjesërisht i lirë. “Argumenti i përgjitshëm është se këto shtete i shfrytëzojnë të ardhurat nga nafta kundër rritjes së presionit shoqëror që çon në kërkesë për më shumë përgjegjësi të qeverisë”[47]. Shtetet rentiere të Gjirit nuk kanë një të kaluar demokratike, por të një sistemi sundimi të cilën ato e kanë trashëguar nga e kaluara; rritja e të ardhurave nga renta atyre iu mundësoi ta forcojnë edhe më shumë

[45] https://pdfs.semanticscholar.org/6a31/422260bbcc7356a644949b4c28cc1ce579a9.pdf, fq. 10
[46] Zakaria, Fareed: *E ardhmja e Lirisë*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë 2004, fq.130
[47] *https://www.sciencespo.fr/kuwait-program/wp-content/uploads/2018/05/KSP_Paper_Award_Fall_2015_LEIPZIGER_Lasse.pdf*, fq. 1

pushtetin. Të ardhurat që realizohen nga shitja e naftës shpërndahen në popull, kurse nga ana tjetër, populli do të garantonte respektim dhe bindje ndaj klasës sunduese; kështu klasa udhëheqëse nuk i nënshtrohet presionit nga poshtë për të nisur procese demokratike dhe në një mënyrë shihet si një "kontratë" mes dy palëve. "Çelësi i stabilitetit relativ i monarkive të naftës ka qenë kultivimi i suksesshëm i një ndjenje të legjitimitetit në mesin e popullatës në përgjithësi dhe midis fiseve në veçanti"[48]. Në këtë mënyrë sunduesit e kompensojnë paqëndryeshmërinë politike dhe e sigurojnë konsensusin politik, pasi masat nuk janë të motivuara për të kërkuar ndryshim, dhe si të tillë ata arrijnë që ta mbajnë pushtetin në mënyrë autoritative. Si rezultat i kësaj në këto shtete nuk kemi një opozitë të mirëfilltë ashtu siç janë në demokracitë e vendeve të botës perëndimore.

Kjo edhe përkundër faktit se në vitin 2010 filloi e ashtuquajtura "Pranvera Arabe" që kishte për synim rrëzimin e regjimeve autoritariste dhe sjelljen e qeverive demokratike të zgjedhura prej popullit. Mund të themi se kjo lëvizje nuk pati ndikim madhor në ndryshimin e sistemit qeverisës, dhe këto shtete vazhdojnë që të jenë regjime monarkiste. Megjithatë nuk mund të thuhet se ky revolucion nuk pati kurrfarë efekti në këto shtete, pasi u realizuan jo pak reforma që mund të ndikojnë në lindjen e ndonjë opozite në shtetet e Gjirit, si dhe në krijimin e organizatave të pavarura joqeveritare të cilat mund të kenë impakt social, të cilat mund të bëjnë shtypje për reforma demokratike. Çështja e demokracisë është shumë e lidhur me reformat ekonomike dhe këtyre reformave regjimet e vendeve të Gjirit kanë arritur që t'iu shmangen, dhe derisa të kemi një shoqëri që është e varur nga paratë e shtetit demokracia si një sistem qeverisës do të jetë ende shumë larg rajonit. Ndërmarrja e reformave të tilla ekonomike do të paraqiste rrezik për regjimet ekzistuese, pasi një gjë e tillë do të shkaktojë dobësimin apo humbjen e pushtetit nga elitat për shkak të mungesës së legjitimitetit demokratik. Në aspektin social, rentierizmi sjell një ndërlikim të fuqishëm, nga shkaku se si rezultat i të ardhurave nga nafta në këto vende nuk ka një ekonomi dhe sektor privat shumë të zhvilluar. Në aspektin social, shtetet e Gjirit kanë krijuar një shoqëri të varur plotësisht nga të ardhurat që ua krijon shteti. Me rritjen e popullsisë edhe të ardhurat që vijnë nga shteti janë

[48] Kamrava, Mehr: *The Modern Middle East*, University of California Press, California 2011, fq. 299

dobësuar, efekt ky që ka ndikuar në rritjen e pakënaqësive dhe të presionit të brendshëm ndaj shtetit. Arabia Saudite mund të merret si shembull i një shteti që nga viti 1980 kishte rreth 9 milionë banorë, kurse në viti 2018 arriti në rreth 33 milionë, pra një rritje 200 % brenda 30 vjetëve dhe të ardhurat për kokë banori në vitin 1980 ishin rreth 22 mij dollar për kokë banori, kurse në vitin 2001 u ulë në rreth 3000 dollar. Rritja e një shtrese të mesme që gjithnjë e më shumë po fuqizohet dhe që po kërkon reforma politike dhe sociale ofron një prespektivë shpresëdhënëse se edhe në këto vende pavarësisht rentës, një ditë do të triumfojë demokracia.

~~3.~~3.4 Impaktet socio-politike të naftësjellësve dhe gazsjellësve

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Lindja e Mesme paraqet rajonin me rezervat më të mëdha të naftës dhe të gazit në botë, me një pozitë gjeografike që këtij rajoni i ka mundësuar të ketë një peshë shumë të madhe në politikën ndërkombëtare. Vitet e fundit është paraqitur edhe një elemet i ri që edhe më shumë

do t'ia shtojë ndikimin rajonit, do të jetë një faktor i ri përplasjesh mes fuqive me interesa të ndryshme. Bëhet fjalë për tubacionet e naftës dhe të gazit. "Përderisa pothuajse 90% e tregtisë së naftës mbështetet në anije, gati 70% e tregtisë së gazit natyror transportohet përmes tubacioneve"[49]. Ndonëse vendet e Lindjes së Mesme kanë sasi të mëdha të burimeve energjetike ato relativisht ndodhen larg tregjeve të mëdha të konsumit si Europa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Lindja e Largët. Për shtetet si eksportuese edhe importuese është më rëndësi furnizimi i sigurt, i shpejtë dhe i pandërprerë me këto burime, që ka bërë që rrugëkalimet e tubacioneve të fitojnë në peshë në strategjin e tyre. Në këtë rajon kalojnë tubacione të shumta të naftës dhe të gazit me vlerë dhe impakt të ndryshëm dhe fati i tyre ka qenë i ndryshëm varësisht nga zhvillimet botërore dhe rajonale.

Naftëssjellësi i parë në Lindjen e Mesmë është ndërtuar në vitin 193 nga Iraku në Palestinë i njohur si tubacioni Irak-Haifa , por që pas luftës së parë Arabo-Izraelite u mbyll dhe nuk u hap asnjëherë plotësisht, kurse pjesët e tjera që kalonin në Liban apo Siri janë hapur dhe mbyllur shumë herë, varësisht nga ngjarjet e rajonit. Ky naftësjellës mundësoi që nafta irakiane të transportohej deri në brigjet e Mesdheut, Irakut i solli të ardhura ekonomike, kurse vendeve nëpër të cilat kalonte iu siguroi rëndësi politike. Naftësjellësi Trans-Arabik u ndërtua në vitin 1947 dhe sillte naftë nga Arabia Saudite për në Liban, me një kapacitet rreth 30.000 fuçi në ditë. Ka pasur një ndikim të fuqishëm ekonomik dhe social gjatë funksionimit, por në viitn 1990 ai pushoi së funksionuari. Tubacioni Lindje-Perëndim u ndërtua në vitin 1982 dhe barte naftën nga rajoni lindor në rajonin perëndimor të Arabisë në Detin e Kuq. Ka kapacitet prej rreth 5 milionë fuçi në ditë. Kjo ka mundësuar që Arabia të transportojë naftën e saj drejt tregjeve europiane dhe amerikane duke i siguruar impakt socio-politik të fuqishëm e që është aktiv edhe sot. Naftësjellësi Sumed (Suez-Mesdhetar) kalon nëpër Egjipt dhe është një alternativë ndaj Kanalit të Suezit. Përmes këtij tubacioni sillet nafta nga vendet e Gjirit drejt Mesdheut me një kapacitet prej 2.5 milonë fuçi në ditë. Territori i Lindjes së Mesme nuk shërben vetëm për tubacionet nga shtetet e Gjirit, por në të kalojnë edhe burimet energjetike të vendeve të Azisë Qendrore.

[49] *https://www.eeinstitute.org/european-revieë-of-energy-market/EREM%205_Article%20Tatsuo%20Masuda.pdf*

Naftësjellësit dhe gazsjellësit u kanë dhënë peshë strategjike dhe fuqi politiko-ekonomike edhe vendeve të tranzitit.

"Tubacion tranzit përkufizohet si një tubacion nafte ose gazi që kalon nga një territor tjetër 'sovran' për të marrë rrjedhën e saj drejt tregjeve"[50]. Naftësjellësi Kirkuk-Dörtyol-Ceyhan që do të kalonte nga Iraku dhe Turqia, gjatë Luftës së Parë të Gjirit u ndërpre, dhe me vonë përsëri rifilloi punën dhe vazhdon të funksionojë ende me kapacitet rreth 150.000 fuçi në ditë. Ky tubacion do të mundësonte shitjen e naftës irakiane në tregjet e Europës duke realizuar të ardhura të mëdha të cilat do të kishin impakt të madh social, si dhe vendit tranzit do t'i mundësonte pozitë të favorshme strategjike. Tubacioni Baku-Tbilisi-Ceyhan (BTC) do të sjellë naftën nga Arezbajxhani drejt vendeve të Europës. Ky tubacion do të kaloj nëpërmjet Gjeorgjisë dhe Turqisë për të mbërritur në portin Ceyhan të kësaj të fundit. Që para përfundimit, ky tubacion është shndërruar në çështje të rëndësishme politike, pasi dobëson fuqinë ndikuese të Rusisë në Kaukaz si dhe në Europë. Që prej përfundimit të këtij projekti BE-ja furnizohet me naftë nga Azerbajxhani me kapacitet rreth 1 milion fuçi në ditë që nënkuptonte furnizim të sigurt dhe uljen e varësisë nga nafta Ruse. "Për Turqinë, projekti i tubacionit BTC që nga fillimi është parë si një projekt kryesisht me rëndësi gjeopolitike"[51]. Ky tubacion i ka mundësuar Turqisë si një shtet i Lindjes së Mesme të shndërrohet në rrugë kryesore për kalimin e tubacioneve të ndryshme. Gazsjellësi është i levërdishëm edhe në aspektin ekonomik pasi nga tarifat tranzitore Turqia përfiton nga 200 deri në 290 milionë dollarë në vit, si dhe siguron të ardhura nga rritja e aktiviteteve në portin e Ceyhanit që do të ketë imapt direkt për vendin.

"Projekti i Gazit Natyror Trans-Anatolia (TANAP) do të dërgoj gaz natyror nga Shah Denizi II dhe fusha të tjera nga Azerbajxhani përmes Turqisë në Evropë"[52]. Që në momentet e para kur u paralajmërua ky projekt, në vitin 2011, shkaktoi polemika dhe kundërshti të mëdha përshkak se ky tubacion do të ketë ndikim të madh socio-politik jo vetëm për Turqinë por edhe për tërë Europën pasi kapacitetet e tij deri në viti 2026 parashihen të arrijnë deri në 30 miliardë metër

[50] *https://www.chathamhouse.org/sites/default/files/public/Research/Energy%2C%20Environment%20and%20Development/r0309_pipelines.pdf*
[51] *https://www.silkroadstudies.org/resources/pdf/Monographs/2005_01_MONO_Starr-Cornell_BTC-Pipeline.pdf,* fq. 103
[52] *https://dergipark.org.tr/download/article-file/677970,* fq. 39

kubë gaz natyror[53]. Në apspektin politik dhe ekonomik kjo ndërmarrje ishte shumë e rëndësishmë pasi që ky tubacion që kalon nëpër Turqi do t'i jepte një avantazh politik dhe starategjik këtij vendi, duke e shëndrruar në një vend tranzit kyç për kalimin e gazit, si dhe Europa do të kishte një alternativë për të pakësuar varshmërinë nga gazi rus. Rusia e kundërshtoi këtë pasi kjo do të nënkuptonte dobësim të ndikimit të saj në Europë si dhe në Lindjen e Mesme. Po ashtu edhe Irani ishte kundërshtar i këtij projekti pasi ky vend është i dyti në botë për nga rezervat e gazit dhe ky projekt do të dëmtonte pozitën e tij politike dhe ekonomike. Në aspektin shoqëror kjo do të ketë një impakt të madh për Turqinë pasi do ta diversifikojë furnizimin me gaz dhe në këtë mënyrë do ta ta ulë varësinë nga vendet tjera. Turkish Stream është një gazësjellës tjetër që kalon nëpër Turqi dhe sjell gaz natyror nga Rusia me kapacitet rreth 31 miliardë metër kubë. Nëpërmjet këtij tubacioni Rusia synon ta furnizoj Europën me gazin e saj dhe u paraqit si një alternativë ndaj gazësjellësit Nabucco që synonte të sillte gaz nga Azerbajxhani. Irani ka filluar ndërtimin e një gazsjellësi i cili do ta dërgoj gazin iranian drejt Pakistanit të njohur si Peace Pipeline me një kapacitet rreth 40 miliardë metër kub gaz. Ky gazësjellës dëshirohet të shtrihet deri në Kinë, kështu që Irani do të bëhej një nga furnizuesit kryesorë të Kinës me gaz. Kjo do të kishte një impakt të fuqishëm politik dhe shoqëror tek Irani, i cili do t'i forconte pozitat starategjike në industrinë e energjisë dhe do të siguronte të ardhura të mëdha nga shitja e gazit vendit më të populluar të botës. Në këtë gazsjellës do të përfshihej edhe India e cila nëpërmjet Paksistanit dëshiron të ketë qasje në gazin iranian. Pas zbulimit të gazit në Detin Mesdhe, Izraeli do që të bëhet një eksporutes i madh i gazit në rajon dhe në këtë mënyrë të luaj rol relevant në tregun botëror të këtij resursi. Izraeli dëshiron të ndërtojë një gazsjellës që do ta dërgonte gazin në Europë nëpërmjet Qipros dhe Greqisë me një kapacitet rreth 20 miliardë metër kubë në vit. Izraeli dëshiron të ndërtojë një gazësjellës që përmes Turqisë do të kalojë në Europë. Kjo do t'i jepjte një impakt të fuqishëm socio-politik Izraelit pasi do të forconte pozitat e veta politike dhe strategjike dhe në aspektin social do t'i mundësonte të ardhura të mëdha që do të kishin impakt direkt në jetën e qytetarëve dhe të ardhurave të vendit.

[53] Vazhdimësi e TANAP-it është TAP-i (Gazësjellësi Trans-Adritatik) i cili do të kaloj nga Greqia drejt Shqipërisë e pastaj në drejtim të Italisë drejt Europës Perëndimore.

~~2.~~4. Kapitulli III: Gara energjetike Arabi Saudite-Iran

~~1.~~4.1 Dy fuqi rajonale

~~1.~~4.1.1 Arabia Saudite

Formatted: Outline numbered + Level: 1 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 0.5"

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Formatted: Outline numbered + Level: 3 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 1", Tab stops: Not at 1.5"

Mbretëria e Arabisë Saudite është një shtet që gjendet në Azinë Perëndimore dhe zë pjesën më të madhe të Gadishullit Arabik me një sipërfaqe 215.000 kilometra katrorë, që zë rreth 80% të Gadishullit në fjalë. Territori i Mbretërisë së tanishme të Arabis Saudite ka qenë i banuar që në kohërat shumë të lashta nga popuj të ndryshëm që e vërtetojnë edhe zbulimet arkeologjike. Në trojet e shtetit aktual saudit është shfaqur besimi monoteist, Islami dhe në territorin e tij gjenden dy vendet më të shenjta Islame, qyteti i Mekës dhe i Medinës, që këtij shteti i japin një rëndësie të veçantë si vend pelegrinazhi të mbi 1.5 miliardë besimtarëve. ”Arabia Saudite e sotme doli nga sundimi turk pas Luftës së Parë Botërore, kur Ibn Saudi i ribashkoi të gjitha principatat feudale të shpërndara nëpër Gadishullin Arabik me një besnikëri patriarkale dhe përkushtim fetar”[54]. Fillesat e mbetërisë i hasim në vitin 1774 në Nexhd rreth zonës së Rijadit, në pjesën qëndrore të Arabisë kur udhëheqësi i familjes Saud, Muhammed bin Saud se bashku me udhëheqësin fetar Muhamed ibn Abdulvehhab i bashkuan forcat dhe themeluan shtetin e parë saudit dhe larguan e sundimit osman nga Gadishulli Arabik . Emirati i Diriyah u zgjerua shumë shpejt duke marrë edhe qytetin e Mekës. Perandoria Osmane në vitit 1818 dërgoi një ushtri nën udhëheqjen e Ibrahim Pashës djalit të sunduesit të Egjiptit Muhamed Ali Pashës, pas rrethimit disa mujor të kryeqendrës Saudite, rezistenca u thye duke i dhënë fund shtetit të parë Saudit. Në vitin 1902 Abdulazizi, i cili më vonë do të njihej si Ibn Saud e riktheu Rijadin dhe themeloi shtetin e tretë saudit. Në vitin 1921 Ibn Saudi shpallet mbret i Nexhdit, kurse në vitin 1926 ai e pushton Hixhazin, vendet e shenjta të Mekës dhe Medinës dhe shpallet mbret i Hixhazit. Me 22 shtator të vitit 1932 bashkohet mbretëria e Nexhdit dhe Hixhazit dhe kështu krijohet Mbretërin e Arabisë Saudite.

Arabia Saudite paraqet një nga sistemet më unike politike të kohës së sodit. Është një monarki absolute, ku si kushtetutë e vendit është *sheriati* (sistemi juridik Islam) ku feja luan një rol shumë me peshë në përcaktimin e agjendës politike si dhe instrumenti kryesor për të legjitimuar pushtetin. Në këtë vend partitë politike dhe opozita nuk janë të lejuara; pra nuk ekziston një proces demokratik i zgjedhjes dhe i përfaqësimit. Kjo ka bërë që Arabia Saudite të përballet me kritika të shumta si brenda vendit ashtu edhe jashtë, madje të cilësohet edhe si

[54] Kissinger, Henry: *Rendi Botëror*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2015, fq. 137

vend autoritar. Kërkesave për reforma pushteti saudian iu është përgjigjur me disa levizje që kanë shënuar një lloj progresi, por jo aq domethënës. Në vitin 1992 u publikua Ligji Themelor i cili përcakton të drejtat dhe mënyrat e funksionimit të qeverisë, të drejtat civile, ndarjet administrative dhe sistemin qeverisës, por që në thelb ky ligj vetëm e ka institucionalizuar qeverisjen. Në të njëjtin vit u miratua Ligji për Qeverisjen Lokale, territori u nda në 13 provinca. Në vitin 2005 u mbajtën zgjedhjet lokale pas një periudhe tejet të gjatë (zgjedhjet vendore për herë të fundit ishin mbajtur gjatë viteve 1954 dhe 1962). Në këto zgjedhje në të cilat meshkujt sauditë votuan për përfaqësuesit e tyre lokalë pjesëmarrja ishte relativisht e ulët,rreth 20-25%[55]. Zgjedhjet tjera lokale parashihej të mbaheshin në vitin 2009, por u shtynë dhe në vitin 2015 këto zgjedhjet do të ishin me një risi të madhe dhe me një imapkt të madhe socio-politk: në bazë të një ligji të vitit 2011 edhe gratë kishin fituar të drejtën e votës dhe të kandidimit. Në këto zgjedhje 21 femra fituan vende në këshillat bashkiakë që u shpall si një e arritur historike. Përmes hapave të këtillë dëshirohej të arrihej një përfshirje më e madhe e popullatës në procesin e vendimmarrjes.

Në vitin 1993 u themelua Asambleja Këshilldhënëse *(Mexhlis esh-Shura)*, që është një organ që ka funksion vetëm këshillues dhe pa fuqi ekzekutive, pra nuk e ka formën dhe përmbajtjen e një parlamenti të mirëfilltë. Asambleja ka 150 anëtarë të cilët janë të zgjedhur prej mbretit dhe që nga viti 2013 në këtë asamble janë edhe 30 gra; pjesëtarët e kësaj instance zgjidhen me mandat katërvjeçar. Ky këshill ka kompetenca të kufizuara dhe nuk ndikon efektivisht në vendimarrje ose në strukturat e pushtetit[56]. Udhëheqësit fetarë kanë një ndikim të fuqishëm në politikat qeveritare të Mbretërisë. Në shumë raste ata edhe kanë qenë përcaktuesit kryesorë të disa vendimeve qeveritare si në Embargon e Naftës e vitit 1973, në pengimin e vendosjes së trupave aleate gjatë Luftës së Gjirit. Arabia Saudite luan rol aktiv në politikën ndërkombëtare. Ajo është antare e OKB-së që nga viti 1945 dhe është pjesë e shumë forumeve rajonale si Liga Arabe, Këshilli për Bashkëpunim i Gjirit, e OPEC-ut, ku ka luajtur një rol tejet të rëndësishëm në krizën e vitit 1973.

[55] Funksionet e të zgjedhurve lokalë janë shumë të kufizuara për shkak të sistemit monarkist-centralisht të shtetit.
[56] *https://www.refworld.org/pdfid/47387ff1f.pdf*

Arabia Saudite ka një partneritet strategjik me Shtetet e Bashkulara të Amerikës dhe kjo aleancë është shumë e fuqishme dhe me ndikim të veçantë në zhvillimet rajonale. Gjatë Luftës së Ftohtë shteti saudit ishte aleati kryesor i Amerikës dhe vendeve perëndimore në luftën ideologjike kundër komunizmit në rajon, duke luajtur një rol të rëndësishëm politik dhe ekonomik gjatë kësaj periudhe. Kjo aleancë vazhdon të jetë e fuqishme edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, deri në ditët tona. Arabia Saudite në vitet e fundit ka krijuar marrëdhënie të fuqishme edhe me Kinën si fuqia e dytë ekonomike e botës. Rivaliteti brendarajonal është shumë i fuqishëm sidomos me Iranin. Këto dy vende, me dallime etnike, gjuhësore dhe kanë dallime ideologjike, e shohin si kundërshtar dhe konkurrent njëri-tjetrin meqë të dyja synojn ta rrisin ndikimin në rajon. Arabia Saudite e shikon Iranin si një kërcënim dhe si një shtet i cili dëshiron të dominojë dhe t'i udhëheqë çështjet rajonale gjë që është e papranueshme për ta. Sauditët janë shumë të përfshirë në zhvillimet rajonale. Në vitin 2011 pas protestave që shpërthyen në vigjilje të Pranverës Arabe në Bahrejn, Arabia Saudite dërgoi trupa ushtarake për t'i ndihmuar elitës në pushtet për t'i dhënë fund revoltës; po ashtu ajo në vitin 2015 u përfshi në konfliktin e Jemenit që vazhdon edhe sot e këtë ditë duke i prirë koalicionit anti-Huthi, ku përveç Saudisë bënin pjesë edhe Emiratet e Bashkuara, Sudani, Maroko dhe Senegali.

Arabia Saudite ka një ekonomi të fuqishme e cila në vitin 2018 u rendit e 18 në mes ekonomive më të fuqishme në botë. "Kërcimi i jashtëzakonshëm nga një PBV prej 42 miliardë dollarësh në vitin 1970 në 753.8 miliardë dollarë në vitin 2014 është dëshmi e historisë së suksesit saudit"[57]. Mbretëria Saudite është e pasur me burime natyrore, kryesisht ato energjetike, që edhe i kanë dhënë një peshë të madhe në arenën ndërkombëtare. Ajo zotëron rreth 18% të totalit të naftës së zbuluar deri tani në botë, si dhe bën pjesë në gjashtë shtetet me rezervat më të mëdha të gazit. Arabia në vitin 2015 ka prodhuar rreth 12 milionë fuçi në ditë, ku nafta përfshin rreth 90% të eksporteve dhe rreth 75% të të ardhurave të përgjithshme buxhetore. "Ka kohë që nafta u ka sjellë sauditëve një pjesë të pasurisë, ndërsa lëkundja e çmimeve të viteve 1970 i ka shumëfishuar këto pasuri disa herë"[58]. Nafta ka sjellur edhe

[57] *https://www.saudiembassy.net/sites/default/files/WhitePaper_Development_May2017.pdf*, fq. 11
[58] Albright, Madelaine: *Të Fuqishmit dhe i Plotëfuqishmi*, Fan Noli, Tiranë 2018, fq. 255

impakte të fuqishme soci-politike në Arabinë Saudite. Si e tillë ajo llogaritet një shtet rentier i cili nuk merr taksa nga popullata, por qytetarëve u shpërdan të ardhura që vijnë nga nafta. Kohët e fundit ka një tendencë taksimi, por që në krahasim me vendet e tjera që varen nga taksat e popullit mbetet e papërfillshme. Arabia Saudite ka një popullatë prej rreth 33 milionë banorë sipas statistikave të vitit 2018 me një shtim të popullsisë për rreth 3% në vit, që konsiderohet si e lartë pasi në vitin 1980 ajo kishte 9.9 milion banorë. Pra, për rreth katër dekada popullata saudite thuajse është katërfishuar. Rreth 90% e popullatës janë arabë kurse 10% llogariten si afro-aziatikë me religjion mbizotrues islamin sunnit. Deri para bumit ekonomik, për shkak të embargos popullata ishte kryesist rurale kurse sot konsiderohet se më shumë se 80% e popullatës jeton në qytet. Shtimi dhe popullaka relativisht e re paraqet një sfidë për Mbretërinë pasi stabiliteti politik dhe social i saj varet nga të ardhurat që ajo alokon për kokë banori. Të ardhurat në vitin 2017 për kokë banori kanë qenë rreth 20.000 dollarë që mundësuon një standart të lartë jetese. ” Monarkia absolute e Arabisë Saudite kufizon pothuajse të gjitha të drejtat politike dhe liritë civile”[59]. Sipas raporti “Freedom House” të vitit 2018 Arabia Saudite klasifikohet si vend jo i lirë. Në vitet e fundit edhe përkundër kufizimeve kemi një levizje drejt një pluralizmi më të madh politik dhe social. Një klase të mesme me kalimin e kohës ka filluar të fuqizohet dhe të ushtrojë një lloj presioni për modernizim që i ka dhënë efektet e veta me nisjen e proceseve liberale dhe demokratike. Element që bie në sy është mbajtja e zgjedhjeve lokale, e drejta e votës dhe e drejta e pjesëmarrjes së femrave në zgjedhje, e drejta për hapjen e bizneseve private. Vizioni Saudit 2030 synon të krijojë një shtet më demokratik, më liberal dhe më koherent përballë sfidave të këtij mijëvjeçari. Kjo lëvizje mund të ketë impakt të fuqishëm jo vetëm brendashtetëror por edhe në të gjithë Lindjen e Mesme, me gjasë që Arabisë Saudite ndot'ia japë edhe primatin si vend udhëheqës rajonal.

Formatted: Indent: First line: 0.5"

[59] *https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/saudi-arabia, 04.09.2019*

~~2.~~4.1.2 Irani

Formatted: Centered, Outline numbered + Level: 3 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 1", Tab stops: Not at 1.5"

Republika Islamike e Iranit është një shtet që shtrihet në pjesën perëndimore të kontinentit aziatik me një sipërfaqe prej 1.648.195 kilometra katrorë, segment ky që e bën shtetin e dytë më të madh për nga sipërfaqja të Lindjes së Mesme pas Arabisë Saudite. ”Kufijtë e Iranit shtrihen në të gjithë gjatësinë e Gjirit Persik dhe, matanë tyre , në përëndim të ngushticës së Hormuzit, me gjirin e Omanit, që hapet në Oqeanin Indian”[60]. Shtrirja në qendër të Euro-Azisë si dhe kontrolli i Gjirit të Hormuzit i jep Iranit një pozitë të fuqishme strategjike në politikën ndërkombëtare. Irani që më herët ka qenë i njohur si Persi ka një të kaluar të lavdishme si dhe është vendi i lindjes së njërit nga civilizimet më të mëdha dhe më të fuqishme botërore të cilat kanë influencuar historinë njerëzore, si dhe vend i disa perandorive që kanë lënë gjurmë në histori. Perandoria Akamenide 550-330 p.e.r. njihet si Perandoria e Parë Persiane që u themelua nga Kiri i Madh dhe e njëjta shtrihej nga Azia Qendrore deri në kufijt e Europës Lindore dhe Ballkanit, duke përbërë perandorinë më të madhe deri në atë kohë. Perandoria Parthiane u themelua rreth vitit 247 p.e.r. dhe paraqiste një fuqi të madhe politike dhe kulturore të antikitetit. Kjo perandori u pasua nga një tjetër e njohur si Perandoria Sasanide që u themelua në vitin 224 të e.r. dhe jetoi deri në vitin 651 dhe paraqet perandorinë e fundit të persiane.

Me ardhjen e Islamit në territoret iraniane u krijuan disa mbretëri muslimane që kulmuan me formimin e mbretërisë Safevite në shekullin XVI që njihet edhe si zanafillë e Iranit modern. Kjo mbetëri çoi në formimin e një shteti të unifikuar si dhe zgjedhjen e islamit shiit si religjion zyrtar që përbën një element i të fuqishëm kthese në historinë e Iranit dhe të islamit. “Irani u sundua nga disa dinasti shahësh nga viti 1848 deri të Revolucioni i Homeinit të vitit 1979”[61]. Që nga shekulli XVI në Iran ka sunduar një monarki absolute ajo kaxhare. Nga mesi i shekullit XIX shpërthyen protesta të shumta kundër koncesioneve që kishte dhënë monarkia ndaj kompanive të huaja që rezultuan me Revolucionin Kushtetues të vitit 1905. Si rezultat i

[60] Lacoste, Yves: *Gjeopolitika e Mesdheut*, Lira, Tiranë 2011, fq. 573

[61] Buto, Benazir: *Pajtimi*, Rozafa, Prishtinë 2014, fq. 129

këtij revolucioni në vitin 1906 u shpallën kushtetuta dhe parlamenti iranian. Edhe përkundër sjelljes së kushtetutës dhe formimit të parlamentit nuk u rikthye paqja dhe stabiliteti brenda shtetit dhe monarkia vazhdonte të rrezikohej nga revolucioni. Në vitin 1925 rrëzohet dinastia kaxhare dhe në pushtet vjen Rezah Khani, themelues i dinastinë pahlevite që sundoi deri në vitin 1979. Në vitin 1951 presidenti iranian Mohammed Mosaddegh shtetëzoi industirinë e naftës iraniane dhe kërkoi tërheqjen e trupave britanike nga Irani. Përmes një grushtshteti të vitit 1953 ai rrëzohet nga pushteti dhe udhëheqësinë e merr në dorë përsëri Shahu. Homeini përmes Revolucionit Islamik të filluar më 1978 dhe që kulmoi më 1979 e rrëzoi Shahun dhe shpalli republikën islame. "Homeini u kthye nga Franca në 1 shkurt 1979 dhe, më 11 shkurt 1979, ai shpalli një Republikë Islamike të Iranit"[62]. Ky revolucion pati një ndikim të fuqishëm dhe që i dha formë dhe kthesë historike Iranit, ai nuk u kufizua vetëm brenda kufijve të këtij shteti, por edhe në gjithë Lindjen së Mesme dhe më gjerë.

Sistemi Juridik i Iranit bazohet në *sheriat* (kodi juridik islam), por në fuqi janë edhe shumë ligje të së drejtës civile të qeverisjes së kaluar. Sistemi politik iranian është kompleks dhe unik pasi që është një përzierje e demokracisë dhe teokracisë. Në bazë të kushtetuës iraniane, partitë politike dhe organizimet tjera shoqërore janë të lejuara. Lideri Suprem ose *ajetullahu* është figura kryesore udhëheqëse e Iranit. Ai ka pushtet më të madh se sa presidenti dhe si i tillë ai nxjerr dekrete dhe jep vendime përfundimtare për të gjitha çështjet kryesore shtetërore si politika e jashtme, ekonomia dhe çështje tjera, si dhe ka të drejtë ta shkarkojë presidentin. "Dega ekzekutive kryesohet nga presidenti, i cili në praktikë është zyrtari i dytë më i lartë i qeverisë".[63] Presidenti zgjidhet nga qytetarët me një mandat katërvjeçar dhe me të drejtë zgjedhjeje vetëm për dy mandate. *Mexhlisi* ose parlamenti iranian ka 290 antarë, ku pesë ulëse janë të rezervuara për pakicat, dhe përfaqësuesit e tyre zgjidhen me një mandat katërvjeçar. Irani është një shtet i madh me pozitë dhe resurse të mëdha natyore që i mundësojnë ndikim dhe fuqi në politikën e jashtme. Ndërkohë karakteri i revolucionar këtë shtet e ka çuar shpesh në tensione me fqinjët dhe fuqitë tjera të mëdha.

[62] *https://fas.org/sgp/crs/mideast/RL32048.pdf,* fq. *1*
[63] *https://www.loc.gov/rr/frd/cs/profiles/Iran.pdf,* fq. 14

Ajo është pjesë e organizatave më të rëndësishme në botë si e OKB-së, FMN-së, OPEC-ut etj. Irani ka bashkëpunim shumë të afërt me Rusinë dhe Kinën me të cilat ka krijuar një aleancë të fuqishme dhe në një të ardhme mund të jetë pjesë e Organizatës për Bashkëpunim të Shangait, e themeluar nga Rusia dhe Kina në të cilën ka statusin e vëzhguesit dhe ka aplikuar që në vitin 2008 për antare me të drejta të plota. Para Revolucionit, Irani kishte lidhje diplomatike dhe marrëdhënie të fuqishme me SHBA-të, si dhe ishte pjesë e Paktit të Bagdatit, një organzatë kjo e Luftës së Ftohtë që ishte themeluar me përkrahjen e SHBA-ve, por pas revolucionit të vitit 1979 kjo organizatë u shpërbë dhe prej asaj kohe vendet anëtare nuk kanë marrëdhënie diplomatike mes vete. Në rajon Irani e sheh Arabinë Saudite si kundërshtarin e saj ideologjik, etnik dhe kulturor dhe marrëdhëniet në mes dy vendeve janë thuajse vazhdimisht të tensionuara dhe në konkurrencë të hapur për ndikim rajonal. Iraku paraqet një kërcënim tjetër për Iranin për shkak të kontesteve kufitare si dhe përballjes mes dy vendeve se cili prej tyre do të jetë lider i Gjirit. "Saddam Huseini besoi se rënia e Shahut krijoi një boshllëk fuqie që ai do të mund ta shfrytëzonte, si dhe një mundësi për të marrë rolin e Shahut duke ofruar mbrojtje të shteteve të Gjirit nga Revolucioni Islamik"[64]. Pas një luftë tetë vjeçare ajo përfundoi pa një epilog të qartë se cili ishte fituesi, por la pasoja të mëdha për dy vendet si dhe për rajonin në përgjithësi. Irani është përfshirë në të gjitha konfliktet e rajonit si Siri, Irak dhe Jemen duke mbështetur grupacione të caktuara, që në shumë raste nga faktori ndërkombëtar janë akuzuar dhe etiketuar si grupe terroriste. Programi i saj nuklear shkaktoi reagime të ashpra që rezultuan me vendosjen e sanksioneve nga Këshilli i Sigurimit. Këto sanksione e futën Iranin në një izolim ndërkombëtar dhe patën një efekt të fuqishëm ekonomik dhe politik për këtë shtet. Në vitin 2015 u arrit një marrëveshje historike mes Iranit dhe pesë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit plus Gjermanisë që iu dha fund sanksioneve, por në vitin 2018 SHBA-të u tërhoqën nga kjo marrëveshje dhe sërish vendosën sanksione, duke e futur në udhëkryq këtë pakt.

Irani ka një ekonomi të fuqishme; sipas të dhënave të vitit 2014 ekonomia e këtij vendi llogaritej si ekonomia e 25-të në botë. Do shënuar se pjesa kryesore e ekonomisë iraniane varet

[64] Hinnebusche, Raymond: *The international politics of the Middle East*, Manchester University Press, Oxford 2003, fq. 196

nga nafta dhe gazi. Irani është vendi i parë në Lindjen e Mesme në të cilin është zbuluar dhe prodhuar nafta që në vitin 1911 dhe ka qenë prodhuesi më i madh në botë deri në vitet 1950. Irani zë vendin e katërt me rezervat më të mëdha të naftës si dhe vendin e dytë për nga rezervat e gazit në botë, burime këto që e bëjnë një superfuqi energjetike si dhe eksportuesin e dytë më të madh të naftës në kuadër të OPEC-ut. Në vitin 2012 Irani eksportonte 1.5 milionë fuçi në ditë, por eksporti i saj u godit nga sanksionet e vënë herëpashere. Irani sipas statistikave të vitit 2018 ka një popullatë prej 82 milionë banorësh, me shtim prej 1.20% në vit. Gjuha më e madhe dhe zyrtare në Iran është persishtja, por aty fliten edhe gjuha kurde, turke dhe arabe. Në Iran jetojnë grupe të ndryshme etnike si persianët, kurdët, turkmenët, arabët dhe grupe të tjera më të vogla[65]. Religjioni dominant është islami shi'it, por ka edhe komunitet sunitësh, përkatësi të tjera fetare si të krishterë, hebrej, zorostorianë etj.

Sipas raportit të Freedom House për vitin 2018 Irani llogaritet si shtet jo i lirë. Ekziston një traditë e funksionimit të organizatave joqeveritare brenda Iranit të cilat janë të përfshira në çështje të ndryshme të karakterit shoqëror, kurse ato politike kanë pengesa në funksionimin e lirë. Gratë kanë të drejtën e votës dhe pjesëmarrjes në politikë: në parlamentin Iranin sot numërohen 17 gra përfaqësuese, por në çështjet të tjera si ajo e divorcit apo në sistemi ligjor në përgjithësi shihet favorizimi i burrave, dhe norma që konsiderohen si shtypëse për gratë. Irani në raportet ndërkombëtare paraqitet si shtet i cili shkel të drejtat e njeriut dhe në shumë raste është shënjestër në qendër të kritikave për abuzime. Irani ka një shtresë të mesme të zhvilluar si dhe një popullatë kryesisht urbane dhe të shkolluar që është një shenjë shpresëdhënsëse se në një të ardhme të afërt mund shndërrohet në një demokraci të mirefilltë.

[65] Në Iran jetojnë rreth 5 milionë kurdë të cilët janë kryengritur disa herë me qëllim të shkëputjes dhe krijimit të shtetit të tyre të pavarur.

~~2.~~4.2 Diplomacia energjetike

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Që nga lindjen e shteteve në antikitet është shfaqur nevoja për mbrojtjen dhe realizimin e interesave të shtetit, për zhvillimin e negociatave me vendet e tjera. Nga koha në kohë janë paraqitur nevoja dhe interesa të ndryshme të cilat shtetet është dashur t'i mbrojnë apo t'i arrijnë. Shekujt e mëhershëm janë karakterizuar nga luftra ideologjike, racore, etnike, por në mileniumin e ri do të paraqitet një formë tjetër e përplasjeve mes shteteve (toka-hapësira, burimet nëntokësore) që do të jetë ajo e burimeve energjetike. Që nga e para u vërejt se shekulli 21 do të karakterizohet nga rritja e varësisë nga burimet energjetike që erdhi si rezultati i rritjes së popullatës dhe zhvillimit ekonomik.

Nafta dhe gazi sot paraqesin dy produktet më të kërkuara në botë. Kjo nevojë çoi në krijimin e një lloj diplomacie të veçantë që është karakteristike për këtë shekull Diplomacia Energjetike. "Diplomacia energjetike zakonisht i referohet aktiviteteve diplomatike dhe politikës së jashtme të kryera nga një vend konsumator për të siguruar qasje në burimet energjetike të një vendi prodhues, me qëllim garantimin e sigurisë së furnizimit"[66]. Kjo nënkupton bashkëpunimin mes institucioneve politiko-diplomatike dhe ndërmarrjeve energjetike brenda një shteti për të siguruar importin e energjinsë së nevojshme. Poashtu edhe në vendet eksportuese ndjehet nevoja për bashkëpunim të afërt mes institucioneve politiko-diplomatike dhe ndërmarrjeve energjetike për të siguruar eksportin e naftës dhe burimeve të tjera drejt vendeve importuese. Në këtë kontekst diplomacia energjetike paraqet një instrument të rëndësishëm negocimi, marrëveshjesh në të cilën janë të përfshirë aktorë të ndryshëm më qëllim të krijimit të korrnizës politike me të cilën do të rregullohej tregtia energjetike.

"Elementet globalë të kësaj diplomacie përpiqen të kenë kontroll mbi çmimet (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë dhe Organizata e Vendeve që Eksportojnë Naftë), kurse elementet bazikë janë të përfshirë në luftën për çmimet: vendet prodhuese (Rusia, vendet e Lindjes së

[66] *https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/CP_146.pdf*, fq. 29

Mesme, të Amerikës Latine), vendet konsumatore (Europa Perëndimore, Amerika, Kina, India) dhe vendet tranzitore (Ukraina)"[67]. Diplomacia energjetike nuk është diçka e re, ajo ka qenë e pranishme që në momentet e para të zbulimit të karburanteve fosile. Në arenën ndërkombëtare interesi i shteteve për t'i plotësuar dhe mbrojtur nevojat energjetike nuk ka shënur asnjëherë ulje por vetëm ngritje. Nafta dhe sigurimi i rrugëtimit të saj ka bërë që shtetet në politikat e tyre të jashtme ta karakterizojnë atë si element të rëndësisë së veçant kombëtare duke u bër shkak i përplasjeve, pushtimeve të vendeve të fuqishme. Siguria energjetike është pjesë e çdo strategjie në politikat e jashtme si të vendeve importuese ashtu edhe të atyre eksportuese. Që para Luftës së Parë Botërore kur Winston Churchil si Admiral i Flotës Britanike funksionimin e anijeve ushtarake e kaloi nga qymyri në naftë, nafta gradualisht do të marrë një rëndësi jetike dhe strategjike për shtetet, peshë kjo të cilën e ruan edhe sot e kësaj dite. Nafta deri para Luftës së Parë Botërore përdorej shumë pak dhe përbënte vetëm 4% të energjisë së përgjitshme të konsumuar. Chruchilli ishte politikani i parë që do ta kuptonte rëndësinë dhe vlerën e naftës. Ai gjithnjë theksonte këtë fjali: "Fitimi i luftës është i mundur vetëm nëse lundrojmë në valët e pandërprera me naftë".

Nafta ishte shkaku i një rivaliteti të madh në mes Fuqive të Mëdha të shekullit XX për sundim dhe ndikim një herë në Persi (Iran) e më vonë në të gjithë Lindjen e Mesme. Nafta ishte shkaku që Hitleri sulmoi Rusinë; ai dëshironte qasjen në naftën sovjetike, po ashtu edhe japonezët e sulmuan Amerikën për shkak të embargos së vënë ndaj Japonisë. Krijimi i Paktit të Bagdadit dhe futja e Turqisë dhe Greqisë në NATO kishte si synim mbajtjen të hapura të rrugëve për kalimin e naftës. Në atë periudhë nafta mori rëndësi të veçantë strategjike: furnizimi dhe mbajtja e çmimeve stabile si dhe siguria për transpotin e tyre kanë paraqisnin element parësor për stabilitetin e shteteve. Energjia ka anët e veta të ndikimt të fuqishëm: rritja e çmimit, mungesa e furrnizimit shndërrohet në një problem shoqëror që rrezikon trazira të brendshme dhe tensione rajonale, por edhe botërore. "Por shtetet kanë edhe shqetësime politike për avantazhin potencial që shtetet eksportuese kanë ndaj shteteve importuese dhe ndaj shteteve tranzite (shtete në territorin e të cilave transportohet energjia) thjesht për shkak të

[67] Pajaiti, Ali, "*Diplomacia energjitike*", Portalb, 24.04. ~~prill~~ -2019, https://portalb.mk/607741-diplomacia-energjitike/

pozicioneve të tyre dominuese si furnizues energjie"[68]. Në shumë raste energjia është përdorur si një instrumet apo "armë" diplomatike që pasur ndikim të fuqishëm ekonomik dhe politik në të gjithë botën, dhe shpeshherë energjia është ajo që shteteve të Lindjes së Mesme u siguron integritet, pavarësi si dhe ndikim në sfera të ndryshme. Historia na tregon se kemi raste kur shtetet të pasura me naftë e kanë shfrytëzuar atë si një instrument presioni diplomatik dhe ekonomik që ka shkaktuar tronditje dhe pasoja tek vendet e varura prej saj. Kriza e Naftës së vitit 1973 që e shkaktuan vendet arabe prodhuese të naftës është një instrument i qartë politik, ku nafta u përdor për qëllime politike. Po ashtu edhe Rusia është një vend i cili shumëherë e përdor gazin si presion politik ndaj Europës.

Nafta është pjesë përbërse e çdo politike të jashtme të shteteve dhe në shumë raste ka qenë faktori që u ka dhënë jetë disa prej aleancave që janë funksionale edhe sot, si ajo me Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Arabisë Saudite. Në këtë rast, njëra do siguron sovranitetin dhe pavarësinë, kurse tjetra furrnizim e pandërprerë më naftë. Ish-sekretari amerikan Henry Kissinger theksonte se "nëse arrin ta kontrollosh naftën, do të mund të kontrollosh kombe të tëra ose grupe të kombeve". Shekulli XXI shënohet nga intensifikim i përplasjeve të gjeopolitikës energjetike. Arsye se pse kjo po ndodh në shekullin e ri është se fuqia ekonomike dalëngadalë po kalon drejt vendeve aziatike. Në shekullin XX konsumuesit kryesorë të energjisë ishin vendet e Europës Perëndimore dhe ShBA-të, kurse tani janë paraqitur edhe aktorë të tjerë të rinj dhe të fuqishëm siç janë Kina, India, Japonia që ka ndikuar në rrëshqitjen e gjeopolitikës energjetike drejt Lindjes. Përplasja energjetike i ka dhënë një rëndësi edhe më të madhe rajonit të Lindjes së Mesme dhe Azisë Qendrore pasi në të gjenden rreth 70% të gjithë burimeve energjetike të botës ku shtetet zhvillojnë një diplomaci energjetike tepër aktive në të cilën janë përfshirë aktor rajonalë dhe ndërkombëtarë. Përplasja e re energjetike po zhvillohet rreth Kaspikut, ku sipas parashikimeve gjenden rreth 17% të naftës botërore dhe rreth 46% të gazit natyror. Rusia e ka përdorur diplomacinë energjetike si një mjet presioni politik dhe ekonomik dhe dëshiron që ta ruajë këtë instrument efektiv dhe po

[68] Smith, S, Hadfilde, A , Sunne, T: *Politika e Jashtme*, UET Press, Tiranë 2012, fq. 455

zhvillon një diplomaci të fuqishme me vendet e Lindjes së Mesme me qëllim kordinimin e politikave energjetike.

Një sukese i madh i diplomacisë energjetike ishte marrëveshja e ashtuquajtur OPEC+ në të cilën bënin pjesë anëtarët e kësaj organizate, si vendet e Gjirit, dhe vendet jo-anëtare, si Rusia. “Kjo "Deklaratë e Bashkëpunimit" për të ulur kolektivisht prodhimin e naftës me afro 1.7 milion fuçi për ditë është zgjatur dy herë dhe aktualisht është në fuqi deri në dhjetor 2018”[69] . Kjo ka shkaktuar rritjen e çmimit të naftës dhe e njëjta është aktive edhe sot.

Edhe Kina po zhvillon një diplomaci të fuqishme me qëllim të furnizimit të pa ndërprerë me naftë dhe gaz. Bashkimi Europian ka krijuar një politikë të jashtme energjetike që është shumë aktive në rajon me qëllim që të sigurojë burime alternative energjie nga Lindja e Mesme dhe Mesdheu, që do të ndikonte në uljen e varësisë nga gazi rus. Shtetet e Bashkuara synojnë ta dominojnë tregun e energjisë dhe mbajtjen e çmimit të saj sa më të ulët ngase përbën një interes strategjik. Edhe shtetet prodhuese të Gjirit kanë një diplomaci të fuqishme energjetike që u ka mundësuar atyre që të rrisin ndikimin dhe rolin e tyre në politikën globale. Arabia Saudite falë burimeve të saj dhe prodhimit ka arritur të zhvillojë një diplomaci energjetike të fuqishme duke luajtur një rol të rëndësishëm në OPEC për të përcaktuar nivelin e prodhimit dhe çmimet e naftës dhe gazit. Irani po ashtu në saje të burimeve të veta ka arritur të krijojë një diplomaci energjetike efikase e cila i ka mundësuar ndikim jo vetëm rajonal por edhe global. Kontrolli i ngushticës së Hormuzit, në të cilën kalon rreth 30% e naftës botërore, ia ka shtuar fuqinë diplomatike dhe ndikuese. Me paraqitjen e garës energjetike si dhe me diplomacinë energjetike si një instrumet i sigurimit të saj, është paraqitur edhe një formë tjetër e diplomacisë që është e lidhur me diplomacinë energjetike të njohur si diplomacia e tubacioneve (*tube-like diplomacy*) dhe ajo e gazsjelljësve (*pipeline diplomacy*), që nënkupton transportimin e naftës ose të gazit natyral. “Diplomacia e tubacioneve është promovuar për herë të parë në vitin 2006, kur Gazpromi (si aktor shtetëror) nisi t’i realizonte politikat e veta ekonomike kinse në mënyrë të pavarur, por, më vonë u provua se nuk ishin gjë tjetër përpos se

[69] *https://fas.org/sgp/crs/misc/IN10892.pdf*

një instrument i zyrës ruse të politikës së jashtme"[70]. Kjo diplomaci fokusohet në aftësinë ndikuese dhe negociuse të shteteve në të cilat kalojnë tubacionet e naftës dhe gazit. Pra, këto janë shtete të cilat nuk kanë pasuri energjetike, por fakti së nëpër territoret e tyre kalojnë tubacionet ka ndikuar që ato të kenë një avantazh gjeopolik dhe strategjik. Turqia është një shtet në Lindjen e Mesme që rrugë kalimi i ka shumë tubacione që vijnë nga Azia Qëndrore, Rusia dhe Lindja e Mesme që ia kanë shtuar rëndësinë strategjike asaj, dhe ky shtet po e përdor këtë fuqi të re në mënyrën më të mirë. Sa më shumë që rritet nevoja për energji aq më shumë do të punohet në krijimin e një diplomacie energjetike më efikase dhe kjo do të ketë efekt direkt në pozitën dhe statusin e vendeve prodhuese. Rritja e kërkesës do të ndikojë në rritjen e nevojës për transport më të shpejtë dhe më të sigurt drejt tregjeve dhe kjo do t'iu mundësojë shteteve tranzite të përfitojnë si në aspektin politik ashtu edhe në atë ekonomik.

Formatted: Left

[70] Dağ, E. & Pajaziti, A. *Fjalor i diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare,* Logos-A, Shkup, 2019, fq. 215.

~~3.~~4.3 Impaktet socio-politike të garës energjetike Arabi Saudite-Iran

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

Energjia është shëndrruar në një element afrimi, përçarjeje dhe largimi mes shteteve në çështjen e dominimit dhe sundimi në të cilat janë të përfshirë aktorë të ndryshëm. Garës energjetike nuk i kanë shpëtuar as vendet prodhuese rajonale si Arabia Saudite dhe Irani. Këto dy shtete janë dy nga vendet me rezerva më të mëdha dhe prodhimin më të madh të naftës dhe gazit në Lindjen e Mesme. Energjia paraqet instrumentin kryesor politiko-diplomatik dhe ekonomik për të dyja shtetet, fuqia dhe stabiliteti i të cilave varet nga aftësia e pordorimit të saj (energjisë). Këto dy vende synojnë të jenë aktorët kryesorë me përmasa globale në prodhimin dhe eksportin e burimeve energjetike që kështu do t'iu mundësonte që edhe të jenë liderë të rajonit. Kjo ka ndikuar që të dy vendet të krijojnë politika energjetike që synim të vetëm kanë dominimin e tregut botëror të energjisë, garë kjo që ka çuar drejt tensioneve të fuqishme politike dhe ka sjellë pasiguri në tërë rajonin dhe tregun botëror energjetik.

Arabia Saudite paraqet vendin e dytë me rezervat më të mëdha të naftës në botë të cilat llogariten në rreth 260 miliardë fuçi ose rreth 25% të totalit të naftës së zbuluar, duke e shëndrruar këtë vend në një fuqi energjetike botërore. Siç dihet, Ghavari paraqet fushën më të madhe të naftës në botë. "Në vitin 2014, Arabia Saudite prodhoi rreth 9.5 milionë fuçi për ditë dhe eksportoi afër 7 milionë fuçi për ditë të naftës së papërpunuar"[71]. Ajo paraqet eksportuesin më të madh të naftës në botë me rreth 13% të totalit të përgjithshëm. Në aspektin shoqëror kjo ka një efekt të fuqishëm për shkak se nafta përbën rreth 50% të të ardhurave kombëtare, rreth 85% të eksporteve dhe rreth 80% të buxhetit të saj. Ajo mban rezerva të naftës për arsye politike si dhe ekonomike, ku si shembull kemi gjatë Luftës së Gjirit ajo zëvendësoi prodhimin e Irakut dhe Kuvajtit duke sjellë stabilitet të çmimit dhe të furnizmit[72]. Arabia Saudite renditet në vendin e katërt me rezervat më të mëdha të gazit në botë, por eksporti i saj mbetet relativisht i ulët. Arabia ka një politikë energjetike fleksibile si në nivelin e prodhimit ashtu edhe në atë të çmimit. Synimi më i madh i politikës së saj energjetike është maksimizimi i të ardhurave nga çmimet e larta të naftës, por në anën tjetër nuk do që t'i humbë tregjet e mëdha në të cilët

[71] *https://www.oxfordenergy.org/wpcms/wp-content/uploads/2015/06/MEP-13.pdf*, fq. 8

[72] Mbajtja e rezervave të mëdha ka edhe anën e saj negative pasi kjo mund të shkaktojë mbifurnizim të tregut, për pasojë ulje të çmimit të naftës, gjë që Arabia Saudite dëshiron ta shmangë.

eksporton. Ajo dëshiron të luajë rolin e balancuesit në prodhim dhe në çmimet e naftës në tregjet globale. Politikat saudite të energjisë parashikojnë që në të ardhmen ta ulin varësinë ekonomike nga nafta si dhe të bëhen krahas naftës edhe një fuqi energjetike e gazit natyror. Saudia vazhdon ta shfrytëzojë naftën si një mjet presioni ekomomik dhe politik.

Irani llogaritet si vendi i katërt në botë për nga rezevrat e naftës të cilat arrijnë në rreth 160 miliardë fuçi, pra rreth 13.1% të revervave të vendeve të OPEC-ut dhe rreth 10% të totalit të rezervave botërore. Fusha e Ahvazit paraqet zonën më të madhe të naftës iraniane. Irani në vitin 2018 prodhoi rreth 3.9 milionë fuçi në ditë, që paraqet një shifër me impakte në tregun global të energjisë, me mundësi më të mëdha prodhimi, që relativisht ka mbetur i nivelit të ulët edhe përshkak të sanksioneve aplikuara ndaj këtij shteti. "Irani ka gjithashtu edhe rezervat e dyta më të mëdha të gazit në botë, pas Rusisë"[73]. Irani ka riorientuar dhe rishikuar politikat e saj energjetike të cilat u kushtëzuan nga presioni i sanksioneve ndërkombëtare që patën një efekt të fuqishmë në sasinë e prodhimit dhe të shitjes së gazit dhe të naftës iraniane. Irani synon që të rrisë prodhimin e vet të naftës dhe ta rikthejë atë në nivelin e periudhës së parasanksioneve kur prodhimi i saj arrinte në rreth 4 milionë fuçi në ditë. Rritja e prodhimit dhe eksportimit të gazit paraqet një politikë tjetër që Irani pritet ta realizojë në periudhën e post-sanksioneve. Programi nuklear i Iranit shkaktoi reagime të shumta dhe si rezultat i kësaj këtij shteti iu vunë sanksione të fuqishme të cilat u përkrahën dhe për të cilat u lobua nga ana e Arabisë Saudite. "Sanksionet e vendosura nga Perëndimi e kanë bërë të vështirë për Iranin të shfaqet si një eksportues i madh i naftës dhe gazit"[74]. Përfshirja dhe mbështetja e sanksioneve nga Arabia Saudite fsheh edhe një aspekt tjetër, atë të përplasjes dhe garës energjetike mes dy vendeve si prodhuesit më të mëdhej të organizatës së OPEC-ut dhe konkurrentëve rajonalë energjetikë. Këto sanksione e përfshinë edhe sektorin energjetik të Iranit që patën impakt të fuqishëm socio-politik. Arabia Saudite në vitin 2014 prodhoi 9.5 milionë fuçi në ditë përkundrejt Iranit nën sanksione që në të njëjtin vit prodhonte 1.4 milionë fuçi në ditë. Në aspektin shoqëror vendosja e sanksioneve ia ka ulur të ardhurat, gjë që është reflektuar në mirëqenien

[73] *https://resourcegovernance.org/sites/default/files/documents/rwi_bp_iran21.pdf*, fq. 2
[74] *https://www.esiweb.org/pdf/esi_turkey_tpq_vol9_no2_bezen-balamir-coskun.pdf*, fq. 75

e qytetarëve iranianë. Në aspektin politik Irani do të humbte fuqinë ndikuese dhe përdorimin e naftës si instrument presioni.

Për Arabinë Saudite si përkrahëse e sanksioneve ndaj Iranit eliminimi i një konkurrenti të fuqishëm do të thoshte fitore e artë që do t'i sillte benefite të shumta. Në aspektin social ajo do të përfitonte të ardhura më të shumta nga rritja e nivelit të shitjes dhe kjo përkthehet në nivel më të lartë mirëqenie për popullatën e saj. Në aspektin politik kjo nënkuptonte një instrumet përfitimi dhe presioni për të mbrojtur apo realizuar interesat e veta strategjike dhe ekonomike. Sanksionet ndaj Iranit rezultuan me humbjen e tregjeve dhe klientëve energjetikë , që në aspektin socio-politik do të kshte impakt shumë negativ: humbje e fuqisë eksportuese, zvogëlimin e të ardhurave kombëtare dhe të fuqisë politike[75]. Arabia Saudite përfitoi nga kjo situatë, e zëvendësoi Iranin në tregun energjetik ndërkombëtar, arriti marrëvështje për eksport të naftës me vendet që më herët ishin furnizuar nga Irani. Kjo në aspektin shoqëror nënkuptonte të ardhura më të mëdha, tepër të nevojshme për ekonominë dhe shtetin saudit. Në aspektin politik kjo gjendje do t'iu mundësonte sauditëve pozita më të mira negocimi dhe kushtëzimi për realizimin e interesave nacionale. Nxjerrja e naftës në Arabinë Saudite dhë në Iran është me kosto të ndryshme që kanë një rol jo pak të vogël në garën mes dy vendeve. Në Arabinë Saduite nxjerrja e naftës ka një kosto totale prej rreth 5 dollarësh për fuçi, kurse për Iranin, një kosto rreth 15 dollarë për fuçi. Kjo diferencë ka bërë që Arabia Saudite të jetë më konkurruese në treg se Irani, i ka mundësuar përparësi në garë. Shitjet më të mëdha, çmimet më konkurruese kanë rezultuar në impakte më pozitive socio-politike për palën suadite.

Një sferë tjetër në të cilën shihet përplasja energjetike mes të dy vendeve është ajo e çmimeve të naftës. Në vitin 2014-2015 çmimet e naftës shënuan një ulje të madhe jonormale dhe disa analistë mendojnë se kjo ishte një ulje jo-natyrale: një fuçi në janar të 2015-ës shitej rreth 50 dollarë, kurse në janar të 2016-ës, rreth 40 dollarë.

[75] Të gjthë kompanitë dhe shtetet që bënin tregti me burime energjetike dhe që kishin parashikuar investime në Iran u përfshinë nga sanksionet e OKB-së, që i detyroi kompanitë e huaja të largoheshin nga vendi.

"Përgjegjësia kryesore për rënien e çmimeve të naftës në vitin 2014 mund t'i atribuohet axhendës së politikës së jashtme të Rijadit"[76]. Kjo u pasqyrua si një lëvizje e fuqishme gjeopolitike e Arabis Saudite që synonte të ushtronte presion të fuqishëm ndaj Iranit të goditur nga sanksionet ndërkombëtare. Këto çmime të ulta ushtruan një presion të fuqishëm socio-politik në të dyja vendet, por Irani mbeti më i godituri dhe dëmtuari nga kjo ndërmarrje ndëshkuese. Çmimi më i ulët nënkuptonte të ardhura më të ulta, kështu ekonomia iraniane shënoi rritje negative për rreth 2.2%, inflacion rreth 14% dhe rritje të papunësisë. Në aspektin social kjo do të thoshte të ardhura më të vogla për shtetin, më pak investime dhe mirëqenie më të ulët për qytetarët e saj. Të ardhurat nga nafta janë një instrumet i fuqishëm politik të cilin Irani e shfrytëzon për avancimin e interesave të veta strategjike. Ulja e çmimit të naftës nuk kaloi pa pasoja edhe për vetë Arabinë Saudite. Për ta balancuar buxhetin, asaj i duhet që çmimi për fuçi të jetë rreth 80-85 dollarë, që nënkupton kishte mbetur e dëmtuar nga kjo lëvizje politiko-ekonomike, por efektet ndaj saj ishin më të vogla për shkak të rezervave të mëdha financiare që disponon që llogariten në rreth 700 miliardë dollarë. Në aspektin shoqëror rënia e çmimeve të naftës nuk pati asnjë impakt të dukshëm. Në aspektin politik Arabia Saudite arriti të fitonte pasi i dha një goditje tjetër të rëndë Iranit duke ia ulur fuqinë ndikuese, ndërsa për vete arriti të marrë një avantazhi politik dhe hegjemonist në rajon dhe më gjerë.

Arabia Saudite dhe Irani janë në një garë tjetër energjetike ajo e gjetjes së tregjeve për eksportimin e naftës dhe gazit tek konsumatorët më të mëdhej globalë. Një garë e ashpër është duke u zhvilluar për furnizimin më naftë të Indisë si konsumatori i dytë më i madh në Azi, menjëherë pas Kinës. "Në përgjithësi, në këtë moment shohim një Arabi Saudite që eksporton gati 18 % të naftës së saj në Kinë dhe sipas planit "Saudi Vision 2030" ky vend kërkon të diversifikojë ekonominë e saj"[77]. Përmes diversifikimit synohet që ekonomia Saudite deri në vitin 2030 të mos jetë e varur nga nafta si burim kryesor i të ardhurave të saj, por të krijoj burime tjera ekonomike për mbushjen e buxhetit shtetëror. Arabia Saudite është furnizuesi kryesore më naftë i vendit më të populluar të botës dhe ekonomisë së dytë globale. Kjo i ka mundësuar të ardhura të mëdha që ndikojn në zhvillimin shoqëror. Ndërkohë lidhjet

[76] *https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/Falling-Oil-Prices-English.pdf*, fq. 2
[77] *https://ier.ut.ac.ir/article_66639_0f24201ec860e5c3d07b98145830c7e0.pdf*

energjetike i kanë mundësuar Arabisë Saudite të ketë ndikim edhe në politikbërjen kineze. Edhe Irani eksportoi në këtë vend gjigant por sasia është shumë larg nga ajo e sauditëve. Kjo shihet si një fitore socio-politike e sauditëve në garën energjetike me Iranin. Marrja e këtij tregu nënkupton edhe impakte të fuqishme socio-politike për këdo që arrin të bëhet eksporutesi numër një i Kinës.

Arabia Saudite sot është partneri i 4-t më i madh tregtar (pas Kinës, SHBA dhe Emiratet e Bashkuara Arabe) i Indisë dhe është një burim kryesor i energjisë pasi ky vend plotëson rreth 19% të kërkesës indiane për naftë të papërpunuar[78]. Në vitin 2018 Irani ishte furnizuesi i tretë i Indisë me naftë duke plotësuar rreth 10% të nevojave të saj. Ndërkohë Arabia Saudite ka gjithashtu agjendën e vet në Indi, duke synuar shndërrimin në furnizuesin numër një të këtij vendi. Këtij hapi saudian Irani iu është kundërpërgjur me uljen e çmimeve të naftës së vet. Por rivendosja e sanksioneve nga SHBA-të ndaj Iranit do çojnë në uljen e ndikimit të saj në tregjet rajonale të energjisë. Kjo përbën një goditje të fuqishme socio-politike ndaj Iranit dhe një përfitim për Arabinë Saudite. Në rajonin e Lindjes së Mesme ekziston një garë e fuqishmë në lidhje me Irakun. Iraku ka nevojë për sasi të mëdha të energjisë elektrike dhe gazit të cilin ajo deri tani e ka siguruar nga Irani, gjë që ka ndikuar në rritjen e influencës iraniane në Irak. Për Arabinë Saudite është e papranueshme që një vend fqinj i saj të ndikohet nga Irani. Ndërkohë Arabia Saudite synon që t'i rrisë investimet e saj në Irak dhe të bëhet eksportuesi kryesor energjetik i Irakut. Kjo garë vazhdon edhe sot në mes dy vendeve të zëna ngoje. Impaktet shoqërore të kësaj gare do të jenë të fuqishme kur dy vendet do të sigurojnë tregje të reja dhe eksporte më të mëdha. Irani dëshiron ta forcojë infulencën e vet në Irak, hap ky drejt hegjemonisë rajonale. Në anën tjetër sauditët kërkojnë që përmes energjisë të bëhen fuqi dominuese brenda Irakut, hap ky që do të ndikonte në uljen e infuencës iraniane dhe shmangien e saj nga Iraku. Diskutimet mes Irakut dhe Iranit për bashkëpunim në prodhimin e naftës për të rritur kapacitetet në rreth 9.5 milionë fuçi në ditë Arabia Saudite i sheh si kërcënim. Nëse kjo marrëveshje realizohet pozita e sauditëve si prodhuesi më i madh i OPEC-ut do të rrezikohej dhe kjo do të kishte impakte të fuqishme socio-politke. Arabia do ta përdor garën energjetike si një instrument për të parandaluar aleancën Iran-Irak.

[78] *https://www.mea.gov.in/Portal/ForeignRelation/India-Saudi_Bilateral_Relations.pdf*

Irani synon t'i kundërvihet Arabisë Saudite duke krijuar një organizatë si OPEC-u, jo të naftës por të gazit së bashku me Katarin. Ky ishte shkaku i tensioneve mes dy vendeve: sauditët dhe disa vende tjera arabe i ndërprenë lidhjet diplomatike me Katarin duke e akuzuar atë për aleancë me Iranin. Suksesi i një marrëveshje të tillë do të kishte impakt të fuqishëm negativ socio-politik për sauditët; do t'iu rrëzikohej statusi i fuqisë energjetike. Irani do të korrte suksese pasi do të realizonte të arrdhura të shumta nga shitja e gazit dhe në aspektin politik do të rriste ndikimin në Lidnjen e Mesme dhe në mbarë botën . Sulmi ndaj fushës së naftës saudite në shtator të vitit 2019 nga territori i Jemenit nga grupi Huthi i mbështetur nga Irani ndikoi që të ngriten tensionet mes Arabisë Saudite dhe Iranit. Ky sulm u cilësua si akt terrorist nga autoritetet saudite dhe të njëjtat e akuzuan Iranin se qëndron pas këtij akti duke theksuar se Irani po kërcënon sigurinë e furnizimit energjetik të tregjeve botërore. Ky incident ka shtuar frikën rreth prodhimit dhe eksportimit të burimeve energjetike të Gjirit Persik, me impakt socio-politik ndaj gjithë rajonit e në mënyr të veçant ndaj Iranit dhe Arabisë Saudite.

Një tension me përmasa globale po zhvillohet rreth ngushticës së Hormuzit e cila ka një impakt të fuqishëm energjetik në tregun energjetik botëror[79]. Kjo çështje prek edhe dy vendet e Gjirit Persik, Iranin dhe Arabinë Saudite. Hormuzi paraqet pikën më të rëndësishme energjetike të botës, të cilën Irani ka kërcënuar se do ta mbyllë si përgjigje ndaj rivendosjes së sanksioneve nga SHBA-të. Në vitin 2018 kalimi i përditshëm i naftës ishte mesatarisht 20 milion fuçi në ditë ose i barabartë me rreth 21% të konsumit global të naftës. Si një çështje globale kjo është shëndrruar edhe në një garë energjetike mes Arabisë Saudite dhe Iranit, pasi kjo paraqet pikëkalimin më të rëndësishëm të naftës saudite. Mbyllja e kësaj pike do të kishte impakt shkatërrues socio-politik për Arabinë Saudite pasi ajo është eksportuesi kryesor përmes kësaj ngushtice. Mbajtja hapur e kësaj ngushtice përbën një fitore politiko-ekonomike për Arabinë Saudite në garën me Iranin për supremaci energjetike. Irani me mbylljen eventuale të ngushticës në fjalë do të shkaktonte humbje të madhe dhe dobësim të supremacisë energjetike të Arabisë Saudite.

[79] Situata u tensionua nga sulmet ndaj disa cisternave që transportonin naftë nëpër Ngushticë për të cilën u akuzua Irani. Britania dhe SHBA-të u përgjigjen me dërgimin e flotave të tyre ushtarake afër brigjeve të Hormuzit duke ndikuar edhe më tej në ngritjen e tensioneve.

Formatted: Indent: First line: 0.5"

Formatted: Outline numbered + Level: 2 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 1"

4.4.4 Përplasja Arabi Saudite-Iran për udhëheqje në rajon

Lindja e Mesme si një zonë strategjike çdo herë ka qenë një vend përplasjeje interesash të fuqive botërore se kush do të ishte fuqia që do të kontrollonte një nga zonat më të rëndësishmë botërore. Rivalitetit për sundim dhe liderizëm nuk i kanë shpëtuar as popujt dhe shtetet që gjenden në këtë pjesë të botës. Përplasjet që kanë karakterizuar këtë rajon që në fillesat e erës së re kanë qenë mes dy popujve më të lashtë dhe më të mëdhenj të rajonit persianëve dhe arabëve. Të dy popujt kanë pretenduar rolin e udhëheqësit të rajonit duke vlerësuar se historia, kultura dhe niveli i zhvillimit ua ka dhënë atyre të drejtën për të dominuar. "Tensionet midis arabëve dhe persianëve kanë rrënjë të thella hisotrike"[80]. Mposhtja e Iranit nga arabët në mesin e shkullit VII çoi në islamizimin e Iranit, por ky i fundit arriti t'i bëjë ballë asimilimit kombëtar duke ruajtur identitetine vet persian. Kjo gjë shkaktoi antipati tek popujt arabë që me kalimin e viteve u përforcua edhe nga ndarja sektare dhe ideologjike (sunnitë-shitë) që vazhdojnë të jenë të fuqishme dhe t'i japin formë rajonit. Periudha e krijimit të shteteve moderne arabe vetëm sa e vazhdoi dhe e intensifikoi përplasjen mes dy popujve si dhe mes shteteve arabe dhe Iranit, ku retorikat mes dy shteteve kanë shërbyer edhe si instrument të bashkimi popullor dhe i kanë drejtuar disa prej levizjeve nacionaliste dhe fetare.

Mungesa e një shteti bërthamë islamik ka qenë shkaku kryesor për konfliktet e përhapura të brendshme dhe të jashtme që e kanë karakterizuar botën islame[81]. Arabia Saudite është vend i lindjes së Islamit, ku gjenden dy qytetet e shenjta dhe si e tillë ajo kërkon që të jetë fuqia dominuese e rajonit dhe shteti bërthamë i botës islame. Edhe Irani si një vend tjetër

[80] Parsi, Tritan: *60 vjet Diplomaci në Lindjen e Mesme,* Helgas's Secrets, Tiranë 2013, fq. 87
[81] Hutington, Samuel: *Përplasja e Qytetrimeve*, Logos A, Shkup 2009, fq. 201

musliman më trashigimi perandorake kërkon që të jetë lideri i rajonit dhe të jetë epiqendra besimtarëve muslimanë të botës. Por ndasitë mes njëra-tjetrës, në Arabinë Saudite dominojnë arabët dhe sunnitët, kurse iranianët janë persianë dhe shiitë ka bërë që këto dy vende të jenë në garë të vazhdueshme për supremaci rajonale. Marrëdhëniet mes këtyre dy shteteve kanë qenë relativisht të mira deri kah fundi i viteve 1970, kur ndodhi edhe ngjarja që ia ndryshoi rrjedhën historisë së rajonit. Dy monarkitë, ajo saudite dhe iraniane nga frika e levizjeve të pan-arabizmit dhe socializmit që ishin rrëzik për sundimin e tyre ndikuan që këto dy shtete të afrohen mes vete dhe t'i koordinojnë politikat e tyre në rajon. Kjo ishte një periudhë kur dallimet mes dy vendeve ishin sheshuar ndaj një rreziku të përbashkët edhe më të madh që i vinte në shënjestër të dy vendet. Revolucioni Islamik i vitit 1979 ka pasur një refleksion të fuqishëm në tërë rajonin, përfshirë edhe marrëdhëniet me Arabinë Saudite. Me triumfin e revolucionit nisën përplasje dhe tensionet mes dy vendeve të Gjirit Persik që rrënuan paqen e arritur më herët nga dy monarkitë. Për sauditët, Irani përfaqësonte një forcë destabilizuese të rajonit për shkak të natyrës së saj revolucionare të cilën dëshironte që ta zgjeronte edhe drejt vendeve të tjera të rajonit, posaçërisht drejt vendeve të Gjirit. Në anën tjetër Irani i akuzonte sauditët si të papërshtatshëm për udhëheqjen me dy vendet e shenjta, kurse ktitikën e dyt e bazonte në karakterin monarkist të shtetit saudit. Pushtimi i Xhamisë së Shenjtë (Mesxhid-i Haram) në vitin 1979 për të cilën Arabia Saudite e akuzoi Iranin shënoi kalvarin e përplasjeve mes dy fuqive rajonale. Mbështetja që sauditët i dhanë Irakut gjatë luftës kundër Iranit përbën dimensionin tjetër të këtij konflikti. Arabia Saudite për ta rënduar gjendjen ekonomike të Iranit shtoi prodhimin dhe eksportin e naftës që rezultoi me mbingarkim të tregjeve dhe ndikoi drejtpërdrejt në uljen e çmimit të naftës dhe në uljen e të ardhurave të Iranit. Ky hap i keqësoi edhe më shumë marrëdhëniet mes dy vendeve. Pushtimi i Kuvajtit nga ana e Irakut ngjalli frikën te sauditët të cilët tani më nuk e shihnin Iranin si kërcënimin kryesor dhe kjo ndikoi që të dy vendet të tregonin shenja të afrimit me njëri-tjetrin.

"Pushtimi i Irakut i udhëhequr nga ShBA-të në vitin 2003 e ngjalli sërish animozitetin saudit ndaj iranit"[82]. Rrëzimi i Sadamit çoi në prishjen e balancave rajonale, ku tani fuqi dominuese rajonale do të ishin Arabia Saudite dhe Irani, të cilët u vendosën përballë njëri-tjerit.

[82] *https://ssi.armywarcollege.edu/pdffiles/PUB1395.pdf*, fq. 10

Rikthimi i interesave të Iranit drejt Irakut ringjalli frikën e sauditëve se Iraku mund të shëndrrohej në një vasal të Iranit, psikologji kjo ngriti tensionet mes dy fuqive. Të dyja palët kanë bërë investime dhe kanë shfrytëzuar pakicat e tyre me qëllim avancimin e interesave të tyre në Irak si dhe në minimin e interesave të kundërshtarit. Vala e protestave pro-demokracisë dhe anti-regjimit të vitit 2011 e njohur si Pranvera Arabe solli shqetësime të reja si për Arabinë Saudite ashtu edhe për Iranin në aspekt të prioriteteve të tyre rajonale[83]. Revolucioni shkaktoi trazira dhe paqartësi të shumta rreth të ardhmes së vetë rajonit dhe shteteve që dëshirojnë rolin dominues në të. E filluar si një lëvizje pro demokracisë, shumë shpejt do të shndërrohet edhe në përballje mes fuqive rajonale; secila dëshironte të përfitonte nga situata për ta avancuar pozitën e vet. Arabia Saudite dhe Irani ndihmuan dhe përkrahën lëvizje të ndryshme me qëllim të rritjes së ndikimit dhe rolit të tyre në ato vende. Vala e revolucionit që u shndërrua në luftë shkaktoi shkatërrime dhe shumë viktima, një kataklizmë kjo që vazhdon edhe sot e këtë ditë. Një protestë që filloi për shkaqe sociale, ekonomike dhe politike, shpejt u shndërrua edhe në përballje mes dy Arabisë Saudite dhe Iranit, ku fqinjët akuzohen mes vete.

Arabia Saudite tenton ta bindë Perëndimin se Irani po luan një rol manipulues pas skenave duke mbështetur elementin shiit në Bahrejn[84]. Falë pozitës së favorshme strategjike si fqi i Arabisë Saudite dhe si vend me pasuri të mëdha të naftës, sauditët e konsiderojnë si interes jetik që ta mbojnë regjimin në këtë vend të vogël. Nga ana tjetër, Irani e konsideron Bahrejnin si provincë të saj, dhe ngaqë shumica e banorëve janë shiitë i mbështeti protestat. Intensifikimi i protestave çoi në thirrjen në ndihmë të Këshilit për Bashkëpunim të Gjirit. Ndërkohë sauditët dërguan trupa për t'i shtypur protesutesit që çoi në shuarjen e revoltës dhe mbajtjen në pushtet të familjes sunduese që është aleate e Arabisë Saudite.

Jemeni paraqet një vend tjetër ku konfrontohen Arabia Saudite dhe Irani, ku protestat rreth pakënaqësive politike dhe sociale çuan në protestat e vitit 2011. Edhe këtu sauditët tentojnë t'i kenë në duar penjët, por sërish duke u konfrontuar me Iranin. Në skenë doli konflikti mes pakicës huthiste proiraniane dhe qeverisë jemenase prosaudite[85]. Arabia Saudite

[83] *https://apps.dtic.mil/dtic/tr/fulltext/u2/a555137.pdf*, fq. 9
[84] *https://www.econstor.eu/bitstream/10419/122258/1/719673976.pdf*, fq. 8
[85] *https://digitalcommons.du.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=2027&context=etd*, fq.102

thekson se qëllimi i saj është kthimi në pushtet i qeverisë legjitime të Jemenit që është edhe aleati i saj, përkundër grupit huthist-shiit të mbështetur nga Irani. Ky konflikt nuk ka përfunduar edhe pas 8 viteve, duke lënë pas viktima të shumta dhe tensione të vazhdueshme ne Gjirin Persik.

Siria është vendi tjetër ku shënohet një përballje e ashpër mes Arabisë Saudite dhe Iranit. Në Siri protestat e Pranverës Arabe, që si etablishmet politik konsiderohet si aleat i rëndësishëm i Iranit, kanë filluar në vitin 2011. Edhepse Arabia dhe Irani nuk janë aktorët kryesorë të këtij konflikti, lufta siriane perceptohet si një fushbetejë mes tyre për ndikim më të gjërë rajonal. Irani i dha mbështetje të fuqishme presidentit Asad, forcat ushtarake të së cilit ushtrojnë gjenocid ndaj popllatës civile, kurse Arabia Saudite i mbështet grupet e ndryshme opozitare që veprojnë kundër regjimit diktatorial sirian. Arabia Saudite bën presion ndaj SHBA-ve për një ndërhyrje në Siri që do të rezultonte me përjashtimin e ndikimt Iranian. Lufta vazhdon dhe influenca Iraniane është shumë e fuqishme në Siri dhe në të ardhmen pritet të luaj një rol edhe më të madh në zhvillimet në këtë vend që është simbol i masakrave ndaj popullatës civile, shpesh edhe me armë jokonvencionale. Libani paraqet një tjetër arenë të përplasjeve mes dy fuqive rajonale. Hizbullahu libanez, një lëvizje shiite islamike, është aleati më i fuqishëm jo-shtetëror i Iranit[86]. Irani i ka dhënë mbështetje të fuqishme këtij grupi që nga themelimi i tij në vitin 1982 dhe si rezultat i kësaj përkrahjeje, ka një ndikim të fuqishëm në Liban. Arabia Saudite mbështet grupe të ndryshme sunnite për t'iu kundërvënë influencës Iraniane në Liban.

Në Palestinë shfaqet një përplasje tjetër mes dy vendeve. Arabia Saudite mbështet krahun Fatah (Fet'h) të palestinezve që konsiderohet si më i moderuar, kurse Irani mbështet Hamasin që konsiderohet si krah më radikal i rezistencës palestineze. Në bazë të zhvillimeve rajonale pritet që edhe në të ardhmen konkurrenca mes dy vendeve për supremaci dhe prijësi të vazhdojë.

[86] *https://fas.org/sgp/crs/mideast/R44759.pdf*, fq. 13

Formatted: Indent: First line: 0"

Formatted: Indent: First line: 0"

~~3.~~5. Intervistat

Formatted: Outline numbered + Level: 1 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 0.5"

Rania Maktabi- ligjëruese në Universitetin e Haldenit, Norvegji

1. Si përdoret burimi i naftës nga Saudi Arabia dhe Irani për të siguruar pushtet dhe ndikim rajonal dhe për të treguar veten si një aktor që duhet konsideruar në rajon dhe ndërkombëtarisht?

Përgjigjja:

Në studimet e politikës ndërkombëtare duhet marrë parasysh faktin se shtetet i përdorin të gjitha burimet për të promovuar interesat e veta shtetërore. Këto burime mund të ndahen në dy grupe, grupi solid si për shembull nafta, gazi dhe rezervët ekonomike, gjeografia, madhësia e popullatës e kështu me rradhë dhe grupi tjetër i burimeve, që nuk është solid si për shembull ndikimi, kapaciteti për të ndikuar tek akteret e ndryshëm, rrjeti i aleancave, marrëdhëniet me shtetet fqinje, marrëdhëniet rajonale me shtetet e fuqishme, marrdhëniet me superfuqitë si SHBA etj. Si Irani ashtu edhe Arabia Saudite i përdorin burimet e tyre në mënyrë aktive për të ndikuar në zhvillimet rajonale dhe përtej. Ajo që ndez aksin Iran-Saudi eshte konflikti i thellë ku feja (ndarja shia-sunni), marrëdhëniet me

shtetet fqinje (veçanërisht me Sirinë dhe Libanin), dhe aleancat me fuqitë e mëdha (Rusi, SHBA), janë divergjente, secili shtet i ka aleatët e vet që kanë marrëdhënie konfliktuale me njëra-tjetrën. Kështuqë marrëdhëniet mes Iranit dhe Saudisë karakterizohen me një mori konfliktesh.

2. Si përdoret nafta si mjet politik në rajon?

Përgjigje:

Të gjitha burimet mund të përdoren politikisht. Nafta dhe gazi janë burime aq të rëndësishme për tregun botëror dhe për ekonominë e shteteve saqë nuk mund t'i analizosh pa e parë ndikimin e tyre politik tek shtetet dhe zhvillimet.

3. A ndikojnë burimet energjetike në një rol politik më të fuqishëm në rajon dhe ndërkombëtarisht, apo janë faktorë tjerë, si për shembull ndikimi amerikan në rajon, që vendos për rrjedhat?

Përgjigje: Prodhimi i naftës ka ndryshuar nga ndikimet e ndryshme viteve të fundit. Së pari: Kërkesa për zbritje të karbondioksidit (CO_2) në atmosferë. Kjo merret seriozisht, edhe nga Arabia Saudite e cila sikur shtetet tjera në rajon kërkon burime alternative për të mbajtur pushtetin ekonomik dhe politik në rajon.

Së dyti, për herë të parë SHBA tash e disa vite është më pak e varur nga importi i naftës dhe gazit nga shtetet e Lindjes së Mesme. Shkaku i kësaj është pjesërisht se ka rezerva të mëdha, dhe pjesërisht metodës së re që quhet "fracking", metodë shumë e kontestuar. Së treti, SHBA ka më shumë hapësirë për t'u futur në politikat e Lindjes së Mesme si aktor i vetëm me më pak ndikim nga nafta dhe gazi. Në politikën amerikane ky "çlirim" nga importi i naftës nga Lindja e Mesme ka çuar te një politikë më guximtare dhe më të gjallë.

4. Nafta, një bekim apo një mallkim për regjionin?

Përgjigje:

Kjo teme trajtohet nga Michael Ross në librin e tij *The oil curse: How petroleum wealth shapes the development of nations* (2012)

Të ardhurat e naftës janë të ardhurat e kamatës. Versioni i shkurtër i këtij libri është që sundues dhe udhëheqes politikë bëhen më pak të varur nga të hyrat e tatimeve shtetërore nga popullata kur mund të kenë të hyra të drejtpërdrejta nga nafta dhe gazi. Ky zinxhir mes naftës dhe pushtetit ekonomik eshtë cekur qysh në vitet 50-ta. Por, pasojat politike janë analizuar më gjërsisht në tezën e ashtuquajturën "rentier economy" në vitet 80-ta. Kjo tezë bazohet në faktin që shtetet udhëheqësit politikë që krijojnë të hyra direkte shumë të mëdha nga gazi dhe nafta, pa prodhuar asgjë. Nafta dhe gazi janë aty nga vetë si resurse natyrore. Kjo quhet "kamatë" në politikën ekonomike. Kur organet shtetërore nuk janë të varura nga popullata, gjegjësisht nga taksat, shfaqet tendenca e autoritarizmit. Organet qeverisëse në shtetet e Gjirit kanë krijuar mirëqenie të bazuar në të ardhura të larta, por pa u hapur ndaj zhvillimeve demokratike dhe participimit demokratik. Ajo që eshtë interesant në analizën e Rossit është se kjo tezë është përdorur edhe në Texas dhe në shtete të tjera të Amerikës ku prodhohet nafta. Argumenti i tij është se edhe këto shtete bëhen më pak demokratike, nëkuptimin që pushteti politik anon nga prodhuesit privatë të naftës dhe në këtë menyrë krijohen lidhshmëri të aftërta mes prodhuesve privatë dhe politikanëve. Në këtë drejtim, të dyja palët kanë interes për të ruajtur pushtetin, dhe dhe i pengojnë të tjerët për të thyer *status quo*-në.

Vesel Dauti, ish-Konsull i Jugosllavisë në Libi në periudhën 1980-1984

1. **Si përdoret burimi i naftës nga Arabia Saudite dhe Irani për të siguruar pushtet dhe ndikim rajonal dhe për të treguar veten si një aktor që duhet konsideruar në rajon dhe ndërkombëtarisht?**

Formatted: Numbered + Level: 1 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 0.5"

Përgjigjja:

Arabia Saudite dhe Irani janë dy vende me rezervat më të mëdha energjetike të naftës dhe gazit në botë. Këto dy vende e përdorin naftën në mënyra të ndryshme varësisht nga rrethanat dhe zhvillimet rajonale dhe ndërkombëtare. Si Arabia Saudite ashtu edhe Irani nga

shitja e naftës gjenerojnë të ardhura të larta të cilët transferohen në investime në vendet e Lindjes së Mesme si dhe në mbështetjen e grupeve apo lëvizjeve të ndryshme në rajon. Nevoja për energji i ka bërë disa vende të rajonit të varura nga Arabia Saudite dhe Irani, të ndikueshme nga këto dy shtete. Arabia Saudite e shfrytëzon pozicionin si prodhuesi numër një i OPEC-ut dhe paraqitet si përcaktuesi i sasisë së prodhimit dhe çmimit të naftës, duke u shndërruar kështu në një aktor me ndikim ndërkombëtar. Edhe Irani e përmes kontrollit të Ngushticës së Hormuzit që paraqet rrugëkalimin më të rëndësishëm ndërkombëtar paraqitet si faktor me peshë në arenën e politikave ndërkombëtare.

2. Në ç'mënyrë nafta përdoret si mjet politik në rajon?

Përgjigjja: Shtetet kanë interesa rëndësisë jetike të cilat dëshirojnë t'i mbrojnë apo t'i realizojnë. Vendet e Gjirit që janë të pasura me naftë, një produkt ky tepër i kërkuar dhe i nevojshëm për ekonominë ndërkombëtare dhe që iu ka dhënë avantazh për shfrytëzimin e tij për qëllime politike. E kaluara na ka treguar se ka pasur raste kur nafta është tentuar të përdoret si mjet politik: shembull konkret është kriza e vitit 1973. Madje, mund të thuhet se sot nafta më tepër është një mjet politik se sa ekonomik.

3. A e kanë burimet energjetike rolin politik më të rëndësishëm në rajon dhe ndërkombëtarisht, apo faktorë tjerë, si për shembull ai amerikan?

Përgjigje:

Lindja e Mesme mban në vete rezervat më të mëdha të naftës dhe të gazit; Arabia Saudite dhe Irani janë shtetet me rezervat më të mëdha të këtyre dy resurseve në rajon dhe më gjerë. Edhe përkundër këtij avantazhi të fuqishëm këto shtete nuk arrijnë të kenë një veprimtari të lirë politike për shkak të kompleksitetit të rajonit dhe të tërë sistemit politik ndërkombëtar. SHBA-të paraqesin shtetin më më ndikim në rajon dhe garantuesin e paqes dhe stabilitetit të tij. Si fuqi dominuese ajo ka një përgjegjësi të madhe për mirëfunksionimin e një rajoni kaq të rëndësishëm për ekonominë dhe politikën ndërkombëtare. Si fuqi dominuese Amerika duhet të luajë rolin e balancuesit mes rivaliteteve që kanë shtetet e rajonit me njëri-tjetrin.

4. Nafta, një bekim apo një mallkim për regjionin?

Përgjigje:

Sa i përket naftës së Lindjes së Mesme mund të them se ajo është një përzierje mes bekimit dhe mallkimit. Është bekim për shkak se nafta siguron të ardhurat kryesore për shtetet e Gjirit, madje është shkaku i ekzistimit dhe i funksionimit të disa shteteve të vogla në Lindjen e Mesme. Si mallkim mund të interpretohet në aspektin se sasia e madhe e rezervave të naftës ka tërhequr lakminë e vendeve të ndryshme që kanë bërë që rajoni të mos ketë stabilitet. Një mallkim tjetër është se falë të ardhurave nga nafta, vendet e Gjirit nuk kanë një industri dhe ekonomi të zhvilluar.

~~2.~~ 6. -Konkluzione

Formatted: Font: Bold

Formatted: Outline numbered + Level: 1 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 0.5"

Lindja e Mesme paraqet një rajon shumë strategjik të politikës ndërkombëtare. Vlera e saj ka qenë e njohur që në ankitet, ku perandoritë e mëdha kanë kërkuar që si shenjë e supremacisë së tyre ta fusin këtë rajon nën kontroll. Edhe në kohrat më të vona apo në epokën e modernitetit shtetet perëndimore e kuptuan rëndësinë e saj dhe bënë garë se cili do të ishte zotëruesi i kësaj hapësire relevante. Gjeografia e saj tejet e favorshme e bëri magnet për të gjithë shtetet që dëshironin ta kontrollonin hapësirën që lidh tre kontinente dhe rrugëkalimet ujore që mundësojnë qasje në detet dhe oqeanet e mëdha~~.~~ Atlantik dhe Indian. Periudha e kolonializmit solli edhe ide të reja si nacionalizmi dhe krijimi i shtetit-komb që ishin të reja pë rajonin. Krijimi i shteteve çoi deri te krijimi i aleancave mes vendeve të rajonit dhe fuqive të tanishme globale.

Zbulimi i naftës ia shtoi edhe më shumë rëndësinë këtij rajoni. Ky burim i ri është i një rëndësie të madhe, element ky pa të cilin ekonomia botërore sd'mund të funksionojë. Gazi natyror u paraqit si një element shtesë në rëndësin energjetike të rajonit Ky resurs iu ka dhënë formë marrëdhënieve ndërkombëtare të vendeve të rajonit. Lindja e rentierizmit pati një impakt socio-politik të fuqishëm: populli është i varur nga shteti dhe si rezultat i kësaj, në Gjirin Persik s'ka vend me demokraci të mirëfilltë. Gjeopolitika e tubacioneve i dha një dimension

tjetër përballje mes shteteve me interesa të ndryshme dhe impakt socio-politike për tërë rajonin.

Në rajonin e Lindjes së Mesme Arabia Saudite dhe Irani janë dy fuqitë rajonale më dallime të mëdha në aspekt ideologjik, sektar, etnik. Shtetet e pasura me naftë kanë arritur që ta përdorin shumë mirë diplomacinë energjetike për interesat e tyre shtetërore. Gara energjetike mes Arabisë Saudite dhe Iranit është e ashpër, ku secili synon ta minojë dhe ta dobësojë aftësin energjetike të tjetrit apo të konkurrentit. Jo vetëm energjia por edhe gara për supremaci në rajon ka bërë që të dy vendet të vazhdojnë të jenë të të përfshirë në konfliktet e rajonit, ndonëse këtë shpesh e fshehin. Për momentitn Arabia Saudite mbështetet nga Shtetet e Bashkuara, kurse Irani përkrahet fort nga Rusia. Nafta si burim energjetik ka një ndikim të fuqish në marrëdhëniet mes dy shteteve rajonale dhe dy superfuqive botërore, pasi që të katër shtetet janë superfuqi energjetik. Arabia Saudite është prodhuesi numër nj i naftës në botë dhe si e tillë ajo zotëron tregun botëror duke qenë përcaktuesi kryesor i sasis dhe çmimit Rajoni do të vazhdoj të jëtë i rëndësishëm deri sa nafta është "gjaku i industrisë", dhe rivaliteti Arabi Saudite-Iran do të jetë aktiv deri sa njëri nga këto dy shtete të arrijë të bëhet lider i palëkundshëm i rajonit. Nafta ka një ndikim shumë të madh në marrëdhëniet mes dy fuqive rajonale dhe dy fuqive botërore, pasi që të katër shtetet janë superfuqi energjetike. Mardhëdhëniet mes Amerikanëve dhe Sauditëve në çështjet e naftës shihen si konkurentë, pasi Sauditët janë prodhuesit më të mëdhej të nafts në botë, kurse Amerikanët janë prodhuesi i dytë i naftës në botë. Sauditët dëshirojnë që ti maksimizojnë të ardhurat nga nafta duke e rritur çmimin e saj, kurse Amerikanët si konsumatorët më të mëdhej në botë dëshirojnë çmim më të ulët të saj. Amerikanët theksojnë nevojën e furnizimit të pa ndërprrë më naftë për ti plotësuar nevojat e saj, Sauditët kërkojnë mbrojtjen Amerikane ndaj çdo kërcënimi të bredshëm apo të jashtëm ndaj stabilitetit dhe tërësis territoriale. Arabia Saudite si prodhuesi më i madh në OPEC ra dakord me Rusin në vitin 2016 duke krijuar të ashtuquajturin OPEC PLUS për shkurtimin e prodhimit të naftëës me rreth 1.2 milion fuçi në ditë që do të kishte impakt ne rritjen e çmimit. Për të realizuar të ardhura të mira për dy shtetet çmimi i preferuar është mbi 80 dollar për fuçi. Me anë të kësaj marrveshje synohet që këto dy vende ta mbizotrojnë tregun global të naftës. Marrëdhëniet mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara janë të tensionuara që nga

revolucioni Islamik i vitit 1979 ku edhe burimet energjetike kanë rënddësin e saj në këtë tension mes dy vendeve. Irani është prodhuesi i pestë më i madh i naftës dhe paraqitet si faktor i rëndësishëm në tregun global të naftës , dhe shihen si kundërshtarë apo konkurent ndaj njëri tjetrit pasi burimet energjetike do të mundësonine dhe ndikim më të madh për të dy palët. Kërcënimi i Iranit për mbylljen e Hormuzit që është rrugëkalimi më i rëndësishëm i naftës në botë dhe në anën tjetër Shtete e Bashkuara kanë kërcënuar për ndërhyrje ushtarake në rast mbylljes së kësaj ngushtice. Mardhëniet e Iranit me Rusinë kanë qënë relativisht të tensionuara gjatë hisotirisë. Burimet dhe politikat energjetike kanë bërë që këto vende të ofrohen mes veti për tu kordinuar sa më mir me qëllim maksimalizimine përfitimëve politiko-ekonomike. Irani në kordinim më Rusinë po tentojnë që të krijojn një formë të OPEC-ut por jo për naftë, por për gaz natyrore pasi dy vendet kanë burimet më të mëdha të gazit në botë.

Pyetja që shtrohet është se si do të sillen dhe si do të pozicionohen këto vende në një kontekst post-naftar?

Formatted: Indent: Left: 0"

Formatted: Indent: First line: 0"

~~3.~~7. Bibliografia

Formatted: Font: Bold

Formatted: Outline numbered + Level: 1 + Numbering Style: 1, 2, 3, … + Start at: 1 + Alignment: Left + Aligned at: 0.5" + Indent at: 0.75", Tab stops: Not at 0.5"

Albright, Madeleine: *Të Fuqishmit dhe i Plotëfuqishmi*, Fan Noli, Tiranë 2018

Brzezinski, Zbingniew: *Vizioni Strategjik*, Instituti i Studimeve Ndëkombëtare, Tiranë 2012

Buto, Benazir: *Pajtimi*, Rozaf, Prishtinë 2014

Carthy, Mc, Justin: *Popujt Osmanë dhe Fundi i Perandorisë*, Alsar, Tiranë 2017

Cohen, B, Samuel: *Gjeopolitika*, Instituti i studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2016

Ozakpënar, Jëllmaz: Kultura dhe Qytetrimi, Logos A, Shkup 2003

Davutogllu, Ahmet: *Thellësia Strategjike*, Logos A, Shkup 2010

Goldschmid, Arthur Jr and Davidson Lawrence: *A Concise History of the Middle East*, Westview Press, Boulder 2010

Hinnebusche, Raymond: *The international politics of the Middle East*, Manchester University Press, Oxford 2003

Hutington, Samuel: *Përplasja e Qytetërimeve*, Logos A, Shkup 2009

Kamrava, Mehr: *The Modern Middle East*, University of California Press, California 2011

Kissinger Henry: *A ka nevoj Amerika për Një Politikë të Jashtme*, Plejad, Tiranë 2005

Kissinger, Henry: *Diplomacia*, Leart, Tiranë 1999

Kissinger, Henry: *Rendi Botëror*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2015

Lacoste, Yve: *Gjeopolitika e Mesdheut*, Lira, Tiranë 2011

Laurent, Eric: *Ana e Fshehtë e Naftës*, Botime 55, Tiranë 2014

Lewis, Bernard: *Fundi i Historis Moderne në Lindjen e Mesme*, Botime IDK, Tiranë 2013

Louise, Fawcett: *Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Lindjes së Mesme*, UET Press, Tiranë 2005

Mansfield, Peter: *A history of the Middle East*, Penguin Books, New York 2013

Marshall Tim: *Prisoners of Geography*, Elliott and Thompson Limited, London 2015

Nye, Joseph S, Jr: *Understanding International Conflicts*, Logman, New York 2003

Dağ, E. & Pajaziti, A. *Fjalor i diplomacisë dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare,* Logos-A, Shkup, 2019.

Reka. B, Bashota. B, Sela Y*: Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Insituti për studime politike dhe Ndërkombëtare, Shkup 2018

Smith, S., Hadfilde, A., Sunne, T.: *Politika e Jashtme*, UET Press, Tiranë 2012

Stoessinger G. John: *Përse Kombet Shkojnë në Luftë*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2015

The Prize: The Epic Quest for Oil, Money, and Power, Simon&Schuster, United States 1990

Vukadinoviç, Radovan: *Marrëdhëniet Politike Ndërkombëtare*,Victory, Prishtine 2005

Zakaria, Fared: *E Ardhmja e Lirisë*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë 2004

https://pdfs.semanticscholar.org/6a31/422260bbcc7356a644949b4c28cc1ce579a9.pdf

https://www.un.int/kamal/sites/www.un.int/files/The%20Ambassador%27s%20Club%20at%20the%20United%20Nations/publications/ufdu2011ahme.pdf,

https://www.eia.gov/todayinenergy/detail.php?id=4430#

https://fas.org/sgp/crs/mideast/RL31956.pdf

https://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/research_reports/RR1200/RR1229/RAND_RR1229.pdf

https://www.iemed.org/observatori/arees-danalisi/arxius-adjunts/anuari/med.2018/Chinese_Breakthrought_Arab_Bichara_Khader_Medyearbook2018.pdf

https://www.ui.se/globalassets/ui.se-eng/publications/ui-publications/2019/ui-paper-no.-2-2019.pdf

https://www.opec.org/opec_web/en/data_graphs/330.htm

http://www.globeco.ro/wp-content/uploads/vol/split/vol_2_no_1/geo_2014_vol2_no1_art_002.pdf

http://www.apicorp.org/Research/EnergyReseach/2016/APICORPEnergyResearch_V02_N01_2016.pdf

https://www.econstor.eu/bitstream/10419/193035/1/ees_17_4_fulltext_02.pdf

https://www.oxfordenergy.org/?s=saudi+arabia&v=fbd1e7ba9564

https://www.ifimes.org/en/livestream

https://history.state.gov/milestones/1921-1936/red-line

http://oapecorg.org/Home/About-Us/History

https://www.files.ethz.ch/isn/20499/rev%20Oil_Price_ShocksI.pdf

https://www.sciencespo.fr/kuwait-program/wp-content/uploads/2018/05/KSP_Paper_Award_Fall_2015_LEIPZIGER_Lasse.pdf

https://www.eeinstitute.org/european-revieë-of-energy-market/EREM%205_Article%20Tatsuo%20Masuda.pdf

https://www.chathamhouse.org/sites/default/files/public/Research/Energy%2C%20Environment%20and%20Development/r0309_pipelines.pdf

https://www.silkroadstudies.org/resources/pdf/Monographs/2005_01_MONO_Starr-Cornell_BTC-Pipeline.pdf

https://dergipark.org.tr/download/article-file/677970

https://www.refworld.org/pdfid/47387ff1f.pdf

https://www.saudiembassy.net/sites/default/files/WhitePaper_Development_May2017.pdf

https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/saudi-arabia

https://fas.org/sgp/crs/mideast/RL32048.pdf,

https://www.geopolitica.ru/en/article/halford-mackinder-geographical-pivot-history

https://www.loc.gov/rr/frd/cs/profiles/Iran.pdf

https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/CP_146.pdf

https://fas.org/sgp/crs/misc/IN10892.pdf

https://www.oxfordenergy.org/wpcms/wp-content/uploads/2015/06/MEP-13.pdf

https://resourcegovernance.org/sites/default/files/documents/rwi_bp_iran21.pdf,

https://www.esiweb.org/pdf/esi_turkey_tpq_vol9_no2_bezen-balamir-coskun.pdf

https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/Falling-Oil-Prices-English.pdf

https://ier.ut.ac.ir/article_66639_0f24201ec860e5c3d07b98145830c7e0.pdf

https://www.mea.gov.in/Portal/ForeignRelation/India-Saudi_Bilateral_Relations.pdf

https://ssi.armywarcollege.edu/pdffiles/PUB1395.pdf

https://apps.dtic.mil/dtic/tr/fulltext/u2/a555137.pdf

https://www.econstor.eu/bitstream/10419/122258/1/719673976.pdf

https://digitalcommons.du.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=2027&context=etd

https://fas.org/sgp/crs/mideast/R44759.pdf